

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 187, Maj 2019

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1,5 euro



RRUGA E DUKAGJINIT NUK PO FILLON DHE NUK E DIMË SE KUR DO TË FILLOJË!

AS RRUGA PËR NË FERRIN E DANTES NUK ËSHTË MË SKËTERRË, MË E TMERRSHME, MË SKANDALOZE DHE MË E PËRGJAKUR, SE RRUGA PREKAL – BREGLUMI – QAFË T'THORE.

E QUAJTURA "RRUGA TURISTIKE E THETHIT" NË NJËRËN ANË DHE "RRUGA E VJETËR E DUKAGJINIT" NË ANËN TJETËR, ËSHTË NJË TRAGJIKOMEDI PËR TË QESHUR NJË MINUTË DHE PËR TË QARË NJË JETË.

NË TË DY KRAHËT E POLITIKËS KEMI PARË, DJE DHE SOT, DUKAGJINAS TË MARRIN PJESË, NDOSHTA DHE DUKE U PËRDORUR, DHE JO NË PAK, SI MISH PËR TOP. SIGURISHT ËSHTË LIRIA DHE E DREJTA E GJITHKUJTË TË POZICIONOHET POLITIKISHT, E NE NUK KEMI PSE TË PARAGJYKOJMË VENDIMET E ASKUJT: SECILI ËSHTË NË TË DREJTËN E VET. POR, NGA ANA TJETËR, ARSYETOJMË SE KA ARDHUR KOHA TË MENDOJMË PAK MË SHUMË PËR BASHKËSINË TONË, PASI POLITIKA NUK PO MENDON PËR NE. PRAN-DAJ, GJENDUR NË KËTO RRETHANA, JU BËJME THIRRJE:

- * TË BASHKOHEM E TË BLOKOJMË QAFËN E T'THORËS DHE TË MOS LEJOJMË TË SHKOHET NË THETH, PA FILLUAR VIJIMI I RINDËRTIMIT TË RRUGËS QAFË T'THORE - THETH?
- * TË MOS MARRIM PJESË NË VOTIME, PA FILLUAR RINDËRTIMI I RRUGËS SË DUKAGJINIT DHE PA MARRË GARANCI SE NUK DO TË NDALET PUNA PA U PËRFUNDUAR AJO!

KRYESIA E SHOQATËS ATDHETARE "DUKAGJINIT"

ATJE KU QENDRESA E MUNDI TMERRIN...

Në një vend, me jo shumë kilometër katrorë hapësirë, mund të themi se është e instaluar një nga historitë më rrëqethëse përse i përket persekutimit nga regjimi komunist, persekutim që i tejkalon edhe kufinj të pabesueshmërisë. Ky vend quhet Shqipëri! Është vendi, ku ne kemi qindra breza paraardhës tanë dhe e jetojmë edhe vetë.

2

PO SIKUR SHQIPËRIA TË BËHET ME SHQIPTARË?

Një shprehje e thënë shumë kohë më parë nga Faik Konica, se Shqipëria nuk bëhet me Shqiptarë siç duket është rrënjësor thellë në trurin tonë dhe e besojmë pothuajse të gjithë. Besoj se kjo vjen si pasojë që nga ADN-ja jonë duke parë historikun e luftërave dhe pushtimeve që në lashtësi, gjithmonë kemi pasur një mik të jashtëm dhe kemi kërkuar ta luftojmë e të mbrojmë gjurmë tanë.

4

ATJE KU QENDRESA E MUNDI TMERRIN...

Në një vend, me jo shumë kilometër katrorë hapësirë, mund të themi se është e instaluar një nga historitë më rrëqethëse përse i përket persekutimit nga regjimi komunist, persekutim që i tejkalon edhe kufinj të e pabesueshmërisë. Ky vend

sekretar Z. Luigj Mila njëkohësisht edhe kryetar i Shoqatës të Muzeut të burgut të Spaçit; mbështetur nga United States Conference of Catholic Bishops dhe arkivi Kujto.al, me themelues deputetin Agron Shehaj dhe, përjetova të panjohurën në thelb, tragjizmin e të gjithë atyre të persekutuarve, peshën e dhimbjes, papërkulshmerinë e qëndresës, krenarinë e idealeve të tyre dhe detyrimin moral për të njohur realitetin në thellësitë e tij.

Në ditën e parë të veprimtarisë, me Datën 20 Maj 2019, u bë përrurimi i memorialit të qëndresës, kushtuar të Persekutuarve Politik nën regjimin më të egër komunist që njohu Evropa. Qindra të pranishëm në këtë event, përballë Bashkisë Shkoder, duke përfshirë edhe personalitete të fushave të ndryshme, përjetuan çaste që flisnin më shumë se qindra faqe libri apo mijra fjalë të hedhura në erë.

Shifrat ishin tragjike: 5 548 të pushkatuar; 14 563 të burgosur; 987 të vdekur në burgje; 42 772 të persekutuar.

Memoriali, e thënë edhe nga specialistët e fushës, ishte mjaft përfaqësues në raport me atë që donte të shprehte. E për këtë një falenderim i përket skulptorit të njohur Hashim Kruja, autorit të këtij memoriali.

Në ditën e dytë, datë 21. 05. 2019 dhjetra të persekutuar dhe të tjerë u nisën në orën 8. 00 të mëngjesit drejt ish - kampit të burgut Spaçit të Mirditës.

Spaçi, i izoluar gjeografik, rrethuar nga katër maje malesh. Mund ta quajmë: "Edhe burgu ishte i burgosur!"

I ndërtuar në vitin 1968, rrotull një miniere bakri të shfrytëzuar nga italianët rreth viteve 30-t. Në atë kamp ferri, vua-



Memoriali kushtuar viktimave të komunizmit

quhet Shqipëri! Është vendi, ku ne kemi qindra breza paraardhësish tanë dhe e jetojmë edhe vetë.

I gjendur pranë një veprimtarie treditore të organizuar nga Bashkia Shkoder; nga Instituti I Studimeve për krimet e Komunizmit; Shoqata e të Persekutuarve Politikë; Komisioni "Drejtësi e Paqe" me



Nga e majta, student Astrit Rama e mësuesi Sul Bajraktari.



Duke punuar për të kthyer në Muze burgun e Spaçit.



Salla që dikur kishte qene salla e televizorit, u ligjruan nga shumë të pranishëm, nën drejtimin e Luigj Milës

jtën persekutimin mijra e mijra shqiptar. Në vitet 70-të kapaciteti i të burgosurve brenda tij e kaloi shifrën prej 1400 personash.

Mbërritëm në Spaç rreth orës 11. 00. Fjala nuk mund ta shprehë atë që syri shi-

të terrenit "lulëzonte" fasada e firmës turke që e kishte marrë me konçension. Atje nuk mund të shkelnin as vetë të persekuturit, ndonëse ishin ata që i kishin hapur ato galeri, ishin ata që kishin lënë vitet e rinisë aty...pikërisht aty ku sot 'konçension-



Aleks Dushi e Lazer Kodra.

kon. Gërmadha, rrënoja, ujëra të turbullta, lot në sytë e të pranishmëve, takime të të burgosurve pas tri dekadsh, kujtime rrëqethëse, e mbi të gjitha përvalonte QENDRESA!

Si për ironi të fatit; në pjesën e sipërme



Memoriali kushtuar viktimave të burgosurve, në burgun e Qafë Barit.

ari' vilte tokën shqiptare, ishin ata që nxorren shokët e tyre të pajetë nga thellësitë e minierave, ishin ata që qanin edhe sot për shokët e tyre të mbetur përgjithmonë



Pamje nga pjesëmarrësit, në Spaç

me shpirtira të ngjuar në thellësitë e tyre, pa Kryqe e Gjysmëhanë. Si mund të rezistosh para një momenti kur ish mësuesi i nderuar Sulë Bajraktari, i dënuar 7 vite burg politikisht, takohet pas 36 vitesh me ish-studentin e tij, Astrit Rama që kishte mbaruar studimet në Francë për Gjuhë

metër larg prej nesh drejtoi kamerën dhe tha: “Vijoni! Vijoni bisedën, se unë po ju filmoj. Por, ti professor ule pak kokën se je i gjatë!” - Mësues Sula e ndërpreu bisedën dhe iu drejtua: Unë ta uli kokën!? Po, po, ti ta ulësh kokën! Profesori mprehu shikimin, u përqendrua, u zverdh dhe tha: Aman! - se mos jeni studenti, Ju!? - Po, studenti jam!!! Kamera ra përtokë! U ngjeshën me njëri-tjetrin! Ndërkohë, unë nuk dalloja asgjë tjetër, përveç jakave të tyre që ishin lagur

nga lotët e njëri-tjetrit.

Në këtë kamp, me 21 maj 1973 kishte shpërthyer një revoltë e paparë, me thirrje kundër diktaturës, kundër komunizmit dhe ishte hera e parë që ishte artikulluar shprehja “E duam Shqipërinë si gjithë Ev-



Vendi ku ngarkoheshin skodat me baker.

frëngë dhe Gjuhë - Letërsi dhe pastaj ishte dënuar 6 vite burg vetëm e vetëm se dashuronte një studente franceze.

(Fragment nga takimi midis tyre). **Ishim duke bërë një bisedë në oborrin e burgut, unë, mësuesi Sulë Bajraktari dhe Gjon Brushtulli. Nga shkallët e rrënuara zbriti një njeri rreth të 60-tave. Në dorë mbante një kamer. Tre-katër**

ropa!”

Kulmi i revoltës ishte improvizimi i Flamurit tonë Kombëtar pa yllin komunist dhe vendosja e tij për tre ditë rresht mbi taracën tre katëshe të fjetores. Revolta u shtyp me dhunë nga trupat dhe mjetet ushtarake. Diktatura bëri ‘kurban’ katër Martirët e Revoltës së Spaçit: Pal Zefi, Skender Daja, Dervish Bejko e Hajro Pashai!

Pas shumë dëgjesave, recitimeve e kujtimeve u nisëm në drejtim të Shkodrës. Binte në sy mungesa totale e përfaqësuesve të pushtetit, ndërkohë që ishte befasuese prania e deputetëve dhe studiueve gjermanë, të cilët vinin për të tretin vit radhazi.

Ky kamp është një akt-akuzë, jo vetëm për kohën e diktaturës, por edhe për këto tridhjetë vite pluralizëm. Ai nuk duhet shembur. Duhet investuar. Duhet kthyer në Muze. Ai

flet më shumë se të gjitha parlamentet e 30-viteve. Flet më shumë se simpoziomet, konferencat apo çdo gjë tjetër. Shëmbja dhe zhdukja e tij, do të thotë zhdukje e pjesës më ‘shqipfolëse’ të historisë sonë.

Në ditën e tretë udhëtimi vijoj drejt ish-kampit famëkeq të Qafë-Barit, në rrethin e Pukës. Me të mbërritur në Qafe Bari u përurua Memoriali në nderim të burgosurve dhe të rënëve në Qafë-Barit. Ky memorial ishte financuar nga Kujto.al me themelues ish-deputetin Agron Shehaj.

Vlen të përmendet fryma e bashkëpunimit midis autoritetëve të pushtetit lokal të Fushë-Arrëzitet dhe faktorëve të të persekuturëve politikë. E them këtë, pasi vetëm dy ditë më parë, me propozim të themeluesit Kujto.al, Z. Shehaj, Bashkia Fushë-Arrëz kishte miratuar emëtimin “Revolta e Qafë-Barit” të rrugës që bashkon rrugën nacionale me ish burgun famëkeq të Qafës-Barit.

Me të mbërritur në Qafë-Bari na u shpërfaq para syve i gjithë kalvari i vuajtjeve. Flisnin godinat, dhomat e torturave, dhomat e izolimit, minierat buzëthara, lumi dukej sikur vajtonte, malet e thepësura heshtnin si në ditë zie!

E vetmja gjë ishte një Dron që sillej në lartësi rreth gërmadhave dhe të krijonte idenë se thoshta: Këtu në lartësi janë shpirtirat e atyre që u flijuan në këtë skëterrë! Kamera që filmonin; celularë që shkrepnin fotografi; lot; përqaftime; tregime të shkurtra në formë kujtesash mbinjerëzore e mbi të gjitha ... praseprapë: QËNDRESË!

Edhe këtu, takimet mes bashkëvuajtësve ishin befasuese. Takoheshin pas dekadave. Me peshën e ndryshimeve që sjellin vitet tek gjithkushi, me dëshirën e madhe për të parë njëri-tjetrin. Në shumë raste, ishin fjalët midis tyre që ngjallnin imazhet e kujtesës dhe pastaj përvijonin gjithë episodet e shiritin shumëvjeçar të bashkëvuajtjes. Altin Guzi ishte vetëm 15-vjeç kur u bë ‘banor’ i Qafës së Barit dhe sot takohet pas 32 vitesh me Gjergj Hanin, që ishte vetëm 16 vjeç kur u bë ‘banor’ i këtij burgu famëkeq. Mundësi i njohur, Tonin Dema, takohet pas mbi 30-vitesh me Kosta Gjordenin (një nga heronjtë e revoltës së Qafë-Barit, i cili mbajti për 30 vite plumbin e asaj dite në shpatull edhe pse ishte me një dorë), po kështu me mikun e tij të ngushtë Zef Luka.

Edhe revolta e Qafës së Barit, që u zhvillua me 22 maj 1984 e tronditi diktaturën komuniste. Por, ashtu siç kishte ndodhur njëmbëdhjetë vite më parë në Spaç, edhe kjo u shtyp barbarishtë, duke lënë pas edhe dy Martirët e Saj: Sokol Sokolin dhe



Nga e majta, Lazer Kodra e Agron Shehaj

Tomë Ndojën.



Të shumta ishin pastaj kujtimet, referatet, dëgjesat, këngët dhe recitimet kushtuar kësaj ngjarjeje historike dhe veprimtarie përkujtimore. Edhe këtu, janë ato rrënoja që flasin më tepër se çdo gjë. Aty, në ato



Filip Guraziu dhe ...

shembje e thërmija, copra tullash e betoni, mbetje opingash e çizmesh, gjëmime shpirttrash të mbetur në thellësitë e errëta të galerive është historia jonë e vërtetë për një periudhë kohore jo të shkurtër.

Për një periudhë kohore, në të cilën ‘historia’ heshti e ‘dhuna’ foli. Tani duhet të heshtë ‘dhuna’ e të flasë ‘historia’! Kjo e fundit është aty, në Spaç, Qafë-Bari, Burrel, Tepelenë e shumë e shumë ‘strofulla’ të tjera që kanë prodhuar krime më tepër se mesjetare.

U kthjem nga “Ferri” i tokës shqiptare me një apel të skalitur brenda vetëdijes sonë:

Respektoni, ndihmoni e jepuni atë çfarë u takon këtyre njerëzve, sepse mbi shpatullat e tyre rëndon tortura e tmerrit, në veprën e tyre qëndron historia dhe qendresa!

LAZER KODRA

PO SIKUR SHQIPËRIA TË BËHET ME SHQIPTARË?

Një shprehje e thënë shumë kohë më parë nga Faik Konica, se Shqipëria nuk bëhet me Shqiptarë siç duket është rrënjësor thellë në trurin tonë dhe e besojmë pothuajse të gjithë. Besoj se kjo vjen si pasojë që nga ADN-ja jonë duke parë historikun e luftërave dhe pushtimeve që në lashtësi, gjithmonë kemi pasur një armik të jashtëm dhe kemi kërkuar ta luftojmë e të mbrojmë gjurmët, rrënjët tona.

Në ditët e sotme nuk kemi armiq të jashtëm, por ne kërkojmë me patjetër të gjejmë dikë “të luftojmë”, e luftojmë me vëllain, motrën fqinjët e madje edhe me tokën tonë sepse edhe hedhja e mbetjeve vend e pavend është një formë luftë. Për të gjitha problemet tona gjejmë faktorë të jashtëm politikë, ekonomikë, është e vërtetë, që populli ynë nuk e ka pasur të lehtë rrugën drejt zhvillimit, por të gjitha vëndet kanë problemet e tyre.

Një miku dhe kolegu im Italian ka problem se ka një vit që merr faturën e telefonit fiks nga kompania që ne fakt e ka ndërprerë kontratën, francezet bëjnë protesta për punësimin e të rinjve, e anglezët kanë probleme akoma më të mëdha daljen nga Bashkimi Europian, e ndërsa për Gjermaninë nuk mund të themi gjë sepse ajo i mban problemet e saj brenda shtetpësisë nuk ia thotë botës, e kështu duhet të bëjmë edhe ne.

Në fakt koeficienti i zgjuarsisë nuk na mungon, sepse e tregojmë veten kudo ku shkojmë, bashkëatdhetarët tanë kanë bi-

znese të sukseshme kudo ku shkojmë, këngëtarë, artistë, shkrimtarë që edhe fitojnë çmime të rëndësishme ndërkombëtare, dmth nuk na mungojnë as aftësitë për të qënë të zotët e vetes tonë. E atje kur shkojmë i paguajmë të gjitha taksat, presim mirë në rradhë për të marrë shërbimin që duam, e për më tepër u mësojmë fëmijëve si të themi, “Të lutem”, “Më fal” e “Faleminderit”, ose si të jemi të sjellshëm në bashkësinë ku jetojmë, atje dimë mirë me i nda mbetjet në qese, plastike e ushqimore e ndërsa në tavolinat tona të kafes sa nuk shqyhem kur flasim për politikë, që as nuk na përkasin.

Shprehjen se Shqipëria nuk bëhet me Shqiptarë e ka kundërshtuar edhe ambasadori Austriak z. Johann Sattler duke u shpreh qartë se, Shqipëria ka bërë përparime e krahasojmë me shumë vite më parë.

Një turiste që shkruan për një faqe në internet tha se bukuria e maleve tona është si të jetosh në Zvicër, thjesht duhet t'i doni pak më shumë, por Zvicra është ajo që kur qeveria hodhi si propozim me referendum, që qeveria t'i paguante secilit shtetas 2500 franga zvicerane pavarësisht nëse punonin apo ajo, populli votoi unanimisht. Jo, sepse e dinë për vendin e tyre do të thotë kosto më të larta jetese, si do të ishte votuar kjo në Shqipëri? Se ne këtu e duam paranë të na vijë falas pa u lodhur... eh sikur ti donim pak më shumë malet tona.

E në këtë drejtim sigurisht do t'a lidh me malet e Dukagjinit dhe çfarë mund të bëjë

secili prej nesh më shumë në këtë drejtim!? Një nga simbolet kombëtare të Zvicrës është këmbana e bagëtive duke e dashur fort si simbol të tyre sepse kjo është ajo që din të bëjë më mirë e ngrin edhe i mbështet fort vlerat e saj, në këtë drejtim duhet edhe ne mund të bëjmë shumë më shumë edhe jo të kënaqemi me pak ose të ankojemi për ato që nuk kemi. E kush më mirë se gjenerata e brezit të të rinjve mund të bëjnë në këtë drejtim, sepse ne kemi fatin e madh që kemi lindur në një kohë kur të shkojmë kudo marrim informacione në çdo vend dhe duke marrë më të mirën mund t'ua sugjeruam prindërve e gjyshërve tanë.

Ne e dime se, Dukagjini i ka vlerat të çmuara në pasurinë kombëtare, kemi tokën, ujin, klimën e mbi të gjitha kemi vlerat artistike të patjetësueshme për të na bërë mjaftueshëm krenarë për cilësitë, me të cilat jemi bekuar, por... mesa duket është ajo që thashë në fillim: “Nuk na pëlqën të eci me kohën, na pëlqen e shkuara, se ndoshta është më e sigurt, po anija nuk është ndërtuar të qëndrojë në breg, për më tepër ne nuk na pëlqen edhe të marrim mendime nga të tjerët, duam të jemi vetë zot e vetë shkop, nuk dimë të bashkëpunojmë me njëri – tjetrin”. Por po marrim prapë shembull Zvicrën, meqë turistja na ka krahasuar me të, thënie themelore të shtetit të saj e ka “Të gjithë për një, e një për të gjithë”, edhe një nga cilësitë e të qënurit të sukseshëm është bashkëpunimi, ndoshta duke

punuar bashkë si qytetare të këtyre maleve të Dukagjinit, të këtyre maleve që na përkasin mund të shkojmë bashkë në Europë, e them në Evropë në çështje parimore, se në jemi pjesë e Evropës, ndoshta sikur të ishim më të bashkuar mund të bëjmë diçka për infrastrukturen, mundet edhe të dërgojmë energjinë elektrike në çdo cep të maleve tona, mund edhe të dërgojmë internetin atje, vetëm sikur të punojmë të gjithë bashkë, sepse thuprat kur janë të shumtë bashkë nuk thyhen, është kështu?

Po sikur Shqipëria të bëhet me Shqiptarë?

Po sikur, realisht Konica ta ketë pasur gabim... po sikur secili prej nesh të fillojë të ndërgjegjësohet edhe ti hedhë mbetjet në kosh të paktën dhe jo nga dritarja shtëpisë, nga dritarja e makinës ose nga biçikleta dhe nëse shënon kosh basketbollit apo jo, se nuk e dinë ata, se vetes i bëjnë dëm, se një qese plastike donë 500 vite për t'u tretur... ata nuk e dinë ose nuk duan ta dinë... po sikur të mos e shisnim dinjitetin më pak për një kënaqësi afatshkurter duke shitur e blerë votën, po sikur të prisnim në rradhë si duhet, po sikur të mos e korruptonim doktorin, po sikur ti administratë të ishe më sjellshme!?

Jo për gjë, po vetë populli e thotë, vetëm i zoti e nxjerr gomarin nga balta...

Klodjana Serraj

LIBRI “DUKAGJINI YNË IV” - NJË VLERË E SHITUAR PËR DUKAGJININ DHE MË GJERË

Autorët e vëllimit të katërt “DUKAGJINI YNË”, Prelë Milani dhe Lazër Kodra, në hyrjen e tij na tregojnë se çfarë ka brenda ky libër që po promovohet sot. Ata shkruajnë: “...është një kujtesë mirënjohëse për armatën e përndritur klerikale e martire dukagjinase ndër mote, e cila u vra, u burgos, u syrgjynos, por nuk u shua as në ditët më të zeza të herezisë”. E diku më tej shkruajnë: “...le te jetë një lule loti për atë çetë të shkëlqyer martire ushqyes i idealeve madhore njerëzore, që syri nuk u rrahi qerpik para plumbit, s'u cërnutën para prangave, as nuk u ligshuan para turturave në burgjet e tmerrshme të vdekjes”.

Prelë Milani dhe Lazër Kodra, përveç botimeve të tjera, kanë veçori për Dukagjinin dhe vlerat e gjithanshme të tij edhe botimin serial “Dukagjini Ynë”, vëllimin e katërt të të cilin e kemi në dorë. Katër vëllime voluminoze me qartësi, me tematikë të përcaktuar dhe të menduar mirë, deri tash, janë një enciklopedi e vërtetë për Dukagjinin dhe dukagjinatit me vlera të mëdha dhe të veçanta.

Dukagjini është një krahinë, nga më maloret në Shqipëri, por malësori dukagjinasi, u dashurua me malet ku vendosi të jetojnë, pranoj edhe vështirësitë e tyre, pranoj të jetojnë këtu duke vlerësuar më shumë lirinë, mvehtësinë, se sa përluljen, krrusjen e puthadorën ndaj asnjë pushtuesi të çfardo ngjyre. Më mirë mbret në një vend me vështirësi, se sa i keqpërdorur, i përbuzur me vende më të mira jetese. Nga ato male rrodhën “ujëra” të argjendëta të cilat bartën me vete margaritarë njerëzorë, përveç të tjerash, të cilët shkëlqyen dhe u

shpërndanë në të gjitha anët, por nuk haruan vendin prej nga buronin asnjëherë. Kështu ndodhi edhe me fretnit, bijë të këtyre anëve, e që përëshkruhen nga autorët me shumë dashuri, përkushtim e pasion në këtë vëllim.

Shkrimet e këtij libri janë të thella, bindëse, mbështetur në dokumente, prekin telat e zemrës të gjithë lexuesve. Ato dhe vëllimet e tjera të këtij seriali, janë dhe mund të përdoren si dokumente në tavolinën e studiuesve e historianëve. Ato janë edhe një shembull shumë i mirë për të gjithë ata që merren edhe me këngën dhe folklorin, skenarëve të filmave dokumentarë, reportazheve, kronikave, por edhe skicave dhe artikujve për në shtypin e shkruar dhe medjan elektronike. Këto vëllime janë shumë të besueshme, bindëse, dhe burim referimi me vlera të padisutueshme. I përmenda këto sepse po dëgjojmë e po pasaktësi. Historia kërkon dokumente serioze, dhe në këtë pikpamje, këto vllime, si edhe gjithë botimet e tjera të këtyre autorëve, kanë gjithë sa duhet për raste të tilla. Askush nuk mund të thotë se përse u shkruar për këtë apo për atë person që përfshihet në këto botime. Shkrimet të çfardo strukture, veçanërisht ato me përmbajtje historike, mund dhe duhet të shkruhet mbi bazën e fakteve historike. Duhet të jemi të qartë se nuk futet askush në histori sepse vargëzohen disa rreshta të bukur dhe një vijë melodike të këndshme, ose me mendimin “hajt, se e di unë”. Edhe vetë këngët janë burim i rëndësishëm, kur ato i vë populli, i mëson dhe i këndon masivisht. Dikur as nuk thuhej “me shkruar

këngë”, por “me vu këngë”. E vetmja pagë që merrnin autorët i këngës ka qenë urimi “të lumtë goja dhe të këndoftë zemra”. Madje as nuk janë shkruar por janë kënduar dhe mësuar gojë më gojë. Një këngë e kësaj natyre është dhe e meriton të jenë burim arkivor për të interesuarit. Duke shkruar për ata njerëz dhe ngjarje, si të këtij apo këtyre vëllimeve, opinioni nuk do të pyes me habi e dyshim, kush është ky, ose kur dhe ku ka ndodhur kjo ngjarje.

Në këtë vëllim përfshihet një biografi e zgjeruar, si edhe për të tjerët, për At Daniel Gjeçaj, i cili u lind në Thethin e bukur, të cilin tashmë e njohin në të katër anët e botës, dhe që i vogël i u përkushtua fesë katolike, e u vu në shërbim të saj me të gjitha fuqitë mendore dhe fizike. Unë mendoj se ka ardhur koha që për këtë françeskan të devotshëm për besimin fetar, por edhe më gjerë, për këtë figurë të historisë, dhe të kulturës, për këtë njeri të madh dhe të veçantë, të ngrihet një dhomë muze në Theth, në shtëpinë ku ai u lind dhe të cilin nuk e harroj kurrë. Natyrisht kjo kërkon një projekt të menduar mirë, një bashkëpunim me familjarët e tij në Theth apo kudo ku jetojnë, që, bësoj se do të jenë të gatshëm, me bashkëpunëtorët e At Danielit, me bashkëkrahinarët e bashkëatdhetarët brenda dhe jashtë atdheut, me bibliotekën françeskanë në Shkodër, Ipeshkëvinë Shkodër-Pult, arkivat dhe muzeun dioçezan, arkivat shtetërore në Shkodër dhe në Tiranë, me organet e pushtetit vendor dhe qendror, mbledhjen e përpunimit e kujtimeve të bashkëkohësve, bashkëpunëtorëve, bashkëpunim me historianë dhe studiues, gazetarë, studimin e kujdesëshëm të arkivit dhe bibliotekës së tij, etj. Unë e shikoj shumë të mundshme, në të gjitha drejtimet, ngritjen e kësaj pike kujtese në vendlindjen e tij, e cila do të shërbejë kujtesës të

At Danielit, do ti shërbente të afërmëve të tij kudo që janë, do ti shërbente Thethit, Dukagjinit, Shkodrës dhe Shqipërisë, do ti shërbente historisë dhe kulturës tonë, do ti shërbente edhe turizmit dhe perspektivës së tij. Kapacitetet organizative, mundësitë e ambjenteve, mundësitë materiale, mundësitë dokumentare, etj, janë për tu arritur. Natyrisht, pa tjetër, kërkohet edhe ndonjë mundësi financiare. Unë mendoj se do të gjenden njerëz vullnetmirë për të realizuar këtë objektiv sa të bukur aq edhe i vlefshëm. Pa ja nis nuk bëhet asgjë. Përshkrimi për At Danielin që është bërë në vëllimin “Dukagjini Ynë-IV” janë baza më e mundshme për një projekt të tillë. Në rrugë të vështira gjenden njerëz të mirë, thuhet diku, besaj se kështu do të ndodhë edhe me këtë ide.

Do të ndjehesha shumë i kënaqur po të realizohet kjo ide, në kujtim dhe si një pengesë në rrugën e harrësës për këtë frat të përkushtuar, të këtij bashkëfshatari tim të vyer dhe të pavdekshëm nga punën e tij të madhe.

Klerikët e përshkruar në këtë vëllim janë të gjithë me gjak dukagjinasi, pinjoll të pemës së hershme dhe të bëshme të Dukagjinit. Ne jemi shumë krenar për të gjithë, por ata nuk na përkasin vetëm ne, por gjithë besimtarëve të cilët me emrin e zotit në mendje dhe zemër, me mendime, me fjalë dhe me vepra, nuk u kursyen për asnjë moment në të gjithë jetën e tyre në shërbim të besimit dhe komunitetit. Ne u kemi borzh kujtesën, respektin, besimin dhe mbështetjen e përhershme për kauzën e tyre, gjatë jetës tonë.

Faleminderit Prelë Milani dhe Lazër Kodra për këtë vepër shkruar rrjedhshëm e pastër si ujëvarat e bjeshkëve të Dukagjinit, shumë të vlefshme për sot dhe për brezat që vinë.

Luigj SHYTI

NË DATËLINDJEN E 17-të TË MUZEUMIT MBARË SHQIPTARE, NË TUZ

Në këtë vit të 17 vjetorit të Muzeut ‘Shtjefen Ivezaj’ dhe në paraqitjen e librit, me titull ‘Burrat e Malësisë’ të autorit Ilmi Kurti, ishte diçka e veçantë në raport me rastet e tjera.

Në këtë ishin figura e personalitete në të dy anët e Malësisë së Madhe, në mes tyre ishte Komandantin e Divizionit të Këmbësorisë së Shkodrës ‘Taraboshi’, kolonel Enver Gaba, në vitet 1984 – 1992 dhe komandantit i këtij Divizioni, në vitet 1992 e 1997 – 2000, kolonel Flamur Muça, përfaqësues të Shoqatës Atdhetare ‘Dukagjini’, Ndue Sanaj, Prele Milani, Lazer Kodra, Gjon Kosteri e plot personalitete të kulturës e artit..

Në këtë takim folën dhe përshëndetën këtë takim plot personalitete mbi Muzeun e librin ‘Burrat e Malësisë’, si Fadil Hasmuja, Ditmitrov Popovic, Prelë Milani, Ndue Sanaj, Zef Zeka, poetja Farida Zmijani Ramadani, Gjok Luli e të tjerë.

Përlujë Malësi e Madhe nderi kombit!
Faleminderit Shtjefën Ivezaj dhe Ilmi



Shtjefen Ivezaj duke dorëzuar Kolonel Enver Gabes, ‘Çertifikatën Mirënjohja’

Kuti që më dhatë mundësinë të njihem dhe të shoh nga afër «thesarin»-muzeun e parë Etnografik në Malësi të Madhe, i krijuar brenda mureve të shtëpisë tënde, këtu në Lekaj të Tuzit dhe do ja sugjeroj çdo të njohuri e mikut tim ta vizitojë dhe



Nga e majta Shtjefen Ivezaj, kolonel Enver Gaba, Flamur Muça e Ndue Sanaj

Redaksia

PANAIRI I PUNËS: PROMOVIM PËR NXITJE PUNËSIMI

Puna është qendrore për pjesën më të madhe të jetës sonë, që na mundëson të arrijmë në botë, por edhe çelësin se si e përcaktojmë veten dhe ndjenjën tonë të vetëvlerësimit. Për më tepër, tashmë, në një botë të dykuptimësisë dhe ndryshimeve të paparashikueshme, janë dy timonë kryesorë që po formojnë tregun e punës. Së pari, në ekonominë e sotme globale dhe të paqëndrueshme, një kontigjent i fuqisë punëtore është bërë thelbësore për të përmbushur nevojat e bizneseve në rritje për fleksibilitet. Së dyti, dixhitalizimi ka shkaktuar një automatizim të thellë të punës, me ndikimin që ndryshon nga funksionet rutinë dhe përsëritëse”

Nevojat për tregun e punës janë të mëdha por në të njëjtën kohë papunësia është një tregues në rritje. Psh, papunësia midis të rinjve zakonisht lidhet me probleme të ndryshme sociale. Të rinjtë kanë mbetur të papunë për shkak të sfidave të ndryshme sociale që përballen me të rinjtë. Këto përfshijnë përtacinë në mesin e të rinjve që i bën ata të mos dëshirojnë të kërkojnë për punësim, kështu që ata mbeten të papunë për kohë të gjatë për shkak të elementeve të tilla shoqërore. Këto rezultate themelore të papunësisë mund të çojnë në shkatërrimin shoqëror kur arrijnë nivele të pakontrollueshme. Papunësia mbetet shkaku themelor i të këqijave sociale të shoqëruara zakonisht me nivele të larta të papunësisë. Këto probleme sociale nuk mund të parashikohen kur ato do të ndod-

hin, por ato me siguri do të ndodhin kur papunësia të bëhet e pakontrollueshme.

Një shkak tjetër është edhe që të rinjtë dhe punëkërkuessit nuk kanë informacionin e duhur për oferta pune të ndryshme. Është pozitive që në Shkodër, në pedonalen ‘Kol Idromeno’ në qytetin e Shkodrës u zhvillua ‘Panairi i Punës 2019’ organizuar nga Shërbimi Kombëtar I Punësimit dhe DIMAK, Albania në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Punësimit, Shkodër me qëllim promovimin e panairit të bizneseve si një nxitje tek të rinjtë për tu bërë pjesë e tij por dhe një urë lidhëse mes arsimit profesional dhe tregut të punës. Kjo edhe sipas Drejtores Zj. Rozafa Zmijani e cila ndër të tjera theksoi edhe faktin që shpesh ofertat e punës nuk janë në përputhje me kërkesat e punëkërkuessve. Gjithashtu ajo vuri në dukje se ka vende të lira pune, por problem mbetet fuqia punëtore e kualifikuar. Ky aktivitet u realizua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuessve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Në këtë panair pune janë prezantuar 64 subjekte dhe 474 vende të lira punë.

Pozitive në këtë panair është edhe përfshirja e aktiviteteve që bëhen nga Shoqata apo Biznese Private për persona me aftësi të kufizuara. Gjithëpërfshirja e tyre është një tregues i emancipimit shoqëror që

fton që të gjithë ta shohim aftësinë ndryshme të barabartë në shoqërinë civile, të cilët mund të kontribuojnë me aftësitë e tyre. Ndër këto shoqata që morën pjesë



mund të përmenden si Shoqata ‘Projekti Shpresa’ të cilët patën mundësinë që të paraqesin punimet e tyre artizanale, prej çimentoje dhe prej arti që bëjnë në Qendrën Ditore. Në fakt, vlen të përmendet se përgjatë këtyre katër viteve, ndërmjetësi mi për punësim nga ana e Zyrës Rajonale të Punësimit ka qënë një tipar i spikatur për përfshirjen e këtyre të rinjve në tregun e punës nëpër Fabrika të qytetit të Shko-

të njihet me te, në skajet ma të largerta të botës), u shpreh kolonel Enver Gaba, i cili e shikonte këtë mrekulli për herë të parë.

Me këtë rast u ndanë disa tituj nderi nga Shoqata ‘Ana Mali’, Muzeu ‘Shtjefen Ivezaj’ dhe shoqata Atdhetare ‘Malësia e Madhe’, që u nderuan me titullin ‘Çertifikatë Mirënjohje’:

Kolonel Enver Gaba, Fadil Hasmuja, Dimitrov Popovic, rapsodi Jonuz Delaj, Gjok Luli, Manjola Arizaj Zeka e të tjerë.

dres.

Këto panairë në vetvete janë pozitive, tregojnë aspirata për zhvillim, kulturë dhe integrim por edhe zgjidhje të problemeve

të punësimit nëpërmjet të cilës mjaft punëkërkuess mund të gjejnë mundësi dhe njëfarë mënyrë mund të jetë një formë përmirësimit të situatës së punësimit. Pavarësisht nga kjo, ka shumë për të bërë për reformat drejt përmirësimit të situatës së punësimit të të rinjve e të punëkërkuessve, pasi realiteti tregon se presioni për punë do të vazhdojë të jetë i madh. Nuk është parashikuar rritje e madhe e vëllimit të vendeve të punës dhe zgjerimi i punësimit të përkohshëm duket të jetë një tendencë e rrënjësor thellë që lidhet me zgjerimin e punësimit gjysmë të kualifikuar dhe me futjen e një modeli të menaxhimit të punës që ka tendencë të diferencojë ose fragmentimin e kushteve të punës për të ulur kostot e punës dhe për të arritur kontroll më të madh mbi fuqinë punëtore.

Prandaj, në mbyllje është e rrekomandueshme një qasje gjithëpërfshirëse që kërkon një kombinim iniciativash që përfshijnë në mënyrë të drejtpërdrejtë aktorët e shtetit, të sektorit privat, si dhe mobilizimi i shoqërisë civile për të marrë një interes proaktiv në adresimin e problemeve paraqitur nga papunësia.

Suela Ndoja

NJË INTERVISTË ME HISTORIANIN ATHANAS GEGAJ PËR GJERGJ KASTRIOTIN

KJO INTERVISTË U TRANSMETUA NGA ZËRI I AMERIKËS MË 18 E 19 JANAR TË VITIT 1968

Zoti Gegaj, kur Fan Noli shkroi librin e tij mbi Skënderbeun më 1949, ai tha se vepra juaj frëngjisht mbi Gjergj Kastriotin ishte më e mbaruara që kishte parë dritën gjer në vitin 1949, si nga forma, nga lënda dhe nga baza dokumentare. Përsa kohë punuat për këtë vepër dhe kur e mbaruat?

I mbetem mirënjohës Peshkop Nolit për lavdërimin që shprehu për veprën time "L Albanie et l'invasion turque au XV-e siècle" ose "Shqipëria dhe invazioni turk në shekullin e XV-të "At Noli ka qenë një njeri me kulturë të gjerë dhe ishte po në të njëjtën kohë një ekspert i çështjeve të historisë meskohore të Shqipërisë. At Noli gjeti në këtë vepër gjëra që e interesuan si studioz kompetent të jetës dhe të veprave të Gjergj Kastriotit, prandaj si shqiptar i madh që ishte, ai çëmonte në kulm çdo gjë që ka te bëjë me historinë e popullit shqiptar dhe me lartësimin e tij si komb. Për sa i përket veprës time "Shqipëria dhe invazioni turk në të XV-tin shekull" kam punuar dendur dy vjet. Kërkimet e para i bëra në vitin 1935 dhe vazhdoja në kërkime dhe në përgatitje të librit gjatë vitit 1936. Në dhjetor të këtij viti libri ishte gati për shtyp, por duke qenë thezë doktrinale, m'u desh ta mbroj publikisht në një nga Aulat e Universitetit të Louvain, ku kisha kryer studimet e mia. Libri u gjet interesant dhe autoritetet e Universitetit aprovuan botimin e tij. Libri në fjalë u botua më 1937 në Louvain-Paris dhe një Shtëpi Botuese e Parisit u ngarkua për shpërndarjen dhe shitjen e tij.

Ku i bëtë kërkimet dhe, në qoftë se i mbani mend, në cilët profesorë?

Kërkimet e mia filluan në Paris për ca muaj, ku veçanërisht në "Bibliothèque Nationale" të qytetit gjeta shumë material të dorës së parë. Kurioziteti im u ngjallë veçanërisht kur për kombinacion, më ra në dorë një botim i të mirënjohurit profesor rumun, Constantin Marinesco, i shkruar frëngjisht: "Alfonsi i Vmbreti i Aragonës e i Napolit dhe Shqipëria e Gjergj Kastriotit", botuar në formë broshure nga Shkolla Rumune në Paris më 1923. Libër i vogël po, por një zbulesë për sa i përket historisë së Skënderbeut e relacioneve mes Shqipërisë dhe mbretërisë së Aragonës e të Napolit. Nga Parisi kalova në Napoli, në Romë, në Firence dhe në Venedik, duke u ndalua për ca kohë dhe në Milano. Në arshivat dhe në bibliotekat e këtyre qyteteve gjeta material të shumtë dhe fillova të përpiloj librin. Profesori im i mirënjohur, që e mbikqyri të tërë materialin më dha aprovimin e tij për botim, ky ishte Adolph De Mayer i Universitetit të Louvain.

Si filluat të interesoheni për të shkruar një libër mbi Gjergj Kastriotin?

Interesimi im për historinë e Skënderbeut është një gjë tipikisht shqiptare. Aj është hero i kombit tonë dhe një fytyrë



ndërkombëtare që zotëron në historinë e Europës në të XV shekull. Për më tepër Skënderbeu është ai personalitet që ka nderuar dhe nderon çdo kohë popullin shqiptar. Po interesimi im për historinë e Skënderbeut fillon atëherë kur isha student në Shkodër, dhe veçanërisht kur arriti nga Amerika "Historia e Gjergj Kastriotit" botua në Boston nga At Noli më 1921 me anën e Organizatës Vatra. Ky libër entuziazmoi të tërë moshën e re shqiptare, sepse kishte meritën që jo vetëm se kishte shkrojtur në një gjuhë të bukur, por nga ana tjetër paraqiste heroin tonë në një dritë të re. Leximi i këtij libri më ka shoqëruar për shumë vjet e më në fund më shtyu të kërkoj gjëra të reja për rreth heroit tonë, për t'i paraqitur, edhe botës së jashtme Skënderbeun sipas nevo-

jave të kritikës historike, duke ndarë në sa ishte e mundur fytyrën e tij gjigante nga legjendat.

Ç'ishin disa nga problemet që përballuat gjatë shkrimit të kësaj vepre?

Problemet që m'u paraqitën në përgatitjen e kësaj vepre qenë të shumta. Më së pari duhej që unë t'u zhveshja nga çdo simpati e ndjenjë personale. Historia në këtë rast lipsej të ishte një histori kritike, e bazuar mbi dokumente të kohës, mbi botime, me vlerë kritike që në çdo kohë janë bërë mbi Gjergj Kastriotin. E që një problem i rëndë, sepse Skënderbeu, si në çdo zemër shqiptare, ashtu edhe në mua, mbetej përherë hero i kombit, që gjësend nuk mund ta shndërojë fytyrën e tij! Nga ana tjetër kërkova me çdo mjet të konfrontoj historinë e vërtetë me botime të panumërta mbi Skënderbeun. Këtu m'u desh të luftoj për të paraqitur një Gjergj Kastrioti sipas thënieve historike; po në të njëjtën kohë kërkova, me çdo kusht me çdo mjet, që Skënderbeu të mbetej dhe aj, që na e paraqet legjenda ose më mirë kronika e kohës. Për këtë gjë luftova, por kërkova të mbetem objektiv në çdo rast.

Cilat janë disa nga gjërat e ra, që nuk diheshin më parë, dhe që i vutë në dukje ju në librin tuaj?

Në përgjithësi nuk ekzistonte një vepër kritike mbi Gjergj Kastriotin. Botimet kritike ishin marrë me ca probleme të historisë së Skënderbeut, dhe ato që u paraqiteshin si histori kritike, kishin mungesa te shumta nga çdo pikëpamje. Merita modeste e veprës time është koordinimi i të gjitha këtyre botimeve, duke i konfrontuar me dokumenta të kohës. Merita e kësaj vepre prandaj mbetet në ndarjen e

legjendës nga historia dhe në udhëzimin e ri të një studimi kritik të jetës dhe të veprave të Skënderbeut. Për këtë gjë gurrat e arshivave dhe aktet zyrtare të kohës më udhëzuan të ndaj legjendën nga historia e vërtetë e Skënderbeut.

Ç'është rëndësia e këtyre zbulimeve?

Rëndësia e këtyre zbulimeve për rreth historisë së Gjergj Kastriotit është kryekrejt në metodën e re e kritike që përdora për të paraqitur Skënderbeun në dritën e vërtetë të jetës së tij dhe të veprave të tij. Duke punuar në këtë mënyrë kërkova që Skënderbeu të mbetej aj që është. Dhe më vjen mirë të ju them se historia e Gjergj Kastriotit sa më kritike të jetë, aq më gjigante na paraqitet jeta e tij. Legjenda e lartësoi tepër, por historia e kritika, gjë që kërkova të realizoj me çdo mënyrë, nuk e vogëlsojnë fytyrën e tij si luftëtar, si strateg, si hero i një kohe dhe i një kombi.

Sipas mendimit tuaj, Zoti Gegaj, ç'kuptim ka, ose ç'kuptim duhet të ketë jeta e Skënderbeut për shqiptarët në kohe të sotme?

Jeta e veprat e Skënderbeut janë një shembull i pavdekshëm në gjiun e popullit shqiptar. Kujtimi i tij i drejtoi të gjitha luftërat e orvatjet për liri, që bëri populli shqiptar gjatë shekujve të robërisë deri në ditën e independencës së tij. Jeta dhe vepra e Gjergj Kastriotit janë të bazuara në bashkim të gjithë shqiptarëve. Si në kohëra të kaluara, ashtu edhe sot, jeta dhe veprat e Skënderbeut janë të bazuara mbi vëllazërim të gjithë shqiptarëve, mbi lirinë e vendit nga i huaji, mbi të drejtat e barabarta te çdo qytetari, mbi respektin e çdo shqiptari të ndershëm, dhe mbi ruajtjen e traditave tona, atë të besës, të burrisë, të mikpritjes dhe të krenarisë kombëtare. Për më tepër Skënderbeu na mëson se shqiptari nuk do të kursejë gjësend për t'i ardhur në ndihmë një shqiptari tjetër dhe për të krijuar një atdhe të përbashkët shqiptar, ku secili të jetojë i lirë dhe të punojë për atë vend që na e lanë trashëgim të parët tonë. Ky vend është Shqipëria e Shqiptarëve, ku secili është zot në shtëpi të tij dhe kërkon të jetojë me dinjitet e në bashkim, ashtu siç na mësoi Gjergj Kastrioti. E ku na mësoi edhe një gjë tjetër: Shqipëria është e gjithë shqiptarëve. Këta do ta mbrojnë me çdo mjet e me çdo sakrificë për Atdheun e Shqiptarëve, dhe si vdiset për liri, pa u bë skllav i huaj, pa përlur karakterin burror të popullit shqiptar.

Cili është shkak që Gjergj Kastrioti vonoi të kthehet në Shqipëri për të rrëmbyer Krujën dhe principatën e tij nga duart e turqve?

Shkak kryesor që Skënderbeu vonoi të marrë në dorë drejtimin e rezistencës shqiptare, qytetin e Krujës dhe principatën e atit të tij është njohuria e thellë e fuqisë Otomane. Për më tepër ai, nuk shihte një fuqi tjetër në Evropë, që te ishte



gati të përballej me ushtritë e sulltanëve, që po marshonin ngadhënjyese në të gjitha anët. Shqipëria ishte ndarë në principata, pothuajse të gjitha nën influencën e huaj, turke ose veneciane. Kishte për më tepër parasysh historinë e atit të tij, që nuk pati përkrahje, dhe sa herë ngriti krye, qe përlulë nga ushtria e sulltanëve. Me gjithë këta Skënderbeu ishte në kontakt me princat shqiptarë dhe ëndërronte të kthej sa më parë në Shqipëri për të drejtuar rezistencën shqiptare. Kur pa se një fuqi e re, Hungaria po luftonte në brigje të Danubit, atëherë Gjergj Kastrioti gjeti kohen e volitshme, u kthye në Shqipëri dhe organizoi vendin për të përballuar fuqinë Otomane. Deçizioni i Gjergj Kastriotit të kthehet në Shqipëri dhe të organizojë vendin kundër fuqisë otomane është një nga deçizionet më me përgjegjësi të historisë. Vetëm një Skënderbeu mund të merrte një deçision të atillë! E për këtë gjë, ai është i madh dhe i pavdekshëm në historinë e popujve.

Cilët kanë qenë faktorët që Gjergj Kastrioti, me një fuqi të vogël munda të bëjë ballë forcave të mëdha e të armatosura gjër në dhëmbë të sulltanëve të Turqisë?

Faktorët kryesorë që Skënderbeu me një ushtri të vogël mund t'u bëjë ballë forcave të armatosura të Sulltanëve të Turqisë, sipas mejtimit tim, janë këto: Skënderbeu ishte strateg i përsosur, një komandant, që nuk dinte çka është frika, një njohës i vendit dhe i zakoneve shqiptare; dhe për më tepër Gjergj Kastrioti nuk e la kurrë armikun që t'i imponojë planet e tija në luftë. Fuqitë shqiptare Gjergj Kastrioti Kastrioti i ndante sipas nevojave të rasteve; ky linte përherë një rezervë dhe shetgun të hapur, që të mos rrethohej nga armiku. Më tepër Kastrioti qe ai që e sulmonte armikun duke i dhënë ushtrisë së tij një shembull që ka mbetur një traditë burrërie shqiptare. Ai përbal-

lonte vdekjen si një ushtar i thjeshtë. Ku ishte rreziku më i madh aty ishte Gjergj Kastrioti. E nuk kishte ushtar shqiptar që të mos kërkonte të bëjë atë gjë që bënte Kastrioti! Më në fund Gjergj Kastrioti dhe kapedanët e ushtarët e tij luftonin për liri. Ai dhe ushtarët e tij e dinin se nuk u mbetej tjetër veçse vdekjes ose lirisë. Për këtë gjë Gjergji e trimat shqiptarë shkruan epopenë shqiptare të shekullit të XV. Kjo është epepeja më e bukur e çdo kohe.

Gjergji bashkë me mbrojtjen e Shqipërisë mbrojti edhe Krishterimin dhe qytetërimin e Evropës nga sulmet e turqve. Pra përse disa vende të Evropës, sidomos Venediku nuk i dhanë përkrahjen e duhur?

Nuk ka dyshim se Skënderbeu mbrojti qytetërimin evropian dhe ua theu hovin fuqive otomane që ishin gati të marshojnë në Itali dhe në Europën qendrore. Skënderbeu pati ndihma nga Alfonsi i V i Aragonës dhe i Napolit, si dhe nga papët e Romës që e kishin kuptuar mirë rrezikun otoman. Sa për Venedik, sadoqë ishte një fuqi e madhe detare kjo për shkaqe tregtare kërkonte të mbante marrëdhënie të mira me Turqinë; dhe ishte rivale e mbretit të Aragonës e të Napolit. Më vonë më 1463 e kuptoi rrezikun dhe përkrahi Skënderbeun, por qe tepër vonë.

Pas "Lidhjes së Kapedanëve" që u bë në Lezhë, e cila e vuri në krye Skënderbeun, çfarë formash administrative u shtuan asi kohe në Shqipëri?

Sipas Lidhjes së Lezhës, Gjergj Kastrioti mbetej kryekomandant i forcave shqiptare. Dalë nga dalë të gjithë i bashkoi për rreth vetes së tij, duke u lënë liri në administrimin e principatave të tyre. Këto principata ishin shumë të kufizuara e shpesh te okupuara nga turqit ose nga Venediku. Secila principatë i jepte Gjergj Kastriotit përkrahjen me ushtarë, por shpenzimet e luftës i përbalonte Kastrioti, shpesh herë i ndihmuar nga Mbreti

Alfons, papët e Romës, nga Ragusa dhe nga të ardhurat e kripës. Më vonë pati përkrahje dhe nga Venediku. Forma administrative në Shqipëri në këtë kohë ishte ajo që zotëronte në Europë, duke mos harruar se deri qyteti i Krujës ishte qytet i lirë, prandaj forma administrative u mbështet në ligjet e vendit.

Sipas mendimit tuaj, çfarë drejtimi do të kishte marrë fati i Shqipërisë sikur Skënderbeu të kishte jetuar më gjatë?

Po të kishte jetuar më gjatë Skënderbeu, sadoqë ishte i shtytur në moshë, fatet e Shqipërisë do të ndryshonin. Ai më 1463 bëri një marrëveshje me Republikën e Venedikut, i siguroi Shqipërisë përkrahjen e saj dhe ai vetë qe emëruar komandant suprem i ushtrive shqiptare-veneciane. Për më tepër Skënderbeu do të kishte kohë të udhëzojë djalin e tij Gjonin, kështu që rezistenca shqiptare e përkrahur nga tjera fuqi europiane, do të mund t'i siguronte Shqipërisë lirinë dhe independencën; këtë gjë e meritonte dhe ca fuqi të kohës kishin filluar ta kuptojnë rëndësinë strategjike të Shqipërisë.

Dhe qysh prej kohës që është botuar vepra juaj dhe ajo e Fan Nolit mbi Skënderbeun, a kanë dalë në shesh dokumenta të tjera që nuk dihen më parë rreth jetës dhe luftërave të Skënderbeut?

Studimet përmbi jetën dhe veprat e Gjergj Kastriotit nga koha e botimit të veprës time e pastaj kanë vazhduar. Më së pari është vazhdimi i botimit të Acta Albania dhe Acta Albanie Veneta; këto të fundit përgatitur nga Qendra e Studimeve Shqiptare të Italisë. Dhe At Valentini është duke botuar "Studi Veneti" të "Fondazionit Cini", që kanë të bëjnë me historinë shqiptare gjatë shekujve XIV-XV. 500-vjetori i vdekjes së Gjergj Kastriotit nga shume pikëpamje shpresoj të jetë deçisive përse i përket epokës së Fatosit tonë kombëtar.

Shënim

Shënojmë se 500-vjetori i vdekjes së Gjergj Kastrioti u kujtua me nderime të mëdha në Kosovë dhe në të gjitha viset shqiptare në ish-Jugosllavi. Në këtë përvjetor historik në Prishtinë u organizua një simpozium ndërkombëtar për jetën dhe veprën e heroit tonë kombëtar, ku u shquan historianët nga Shqipëria ne krye me Profesor Aleks Buda. Ky akademik i përmendur në kumtesën e tij për Skënderbeun citoi vazhdimisht Barletin, Nolin dhe Gegaj. Kjo ishte ngjarja më e madhe kulturore që kishte përjetuar Kosova deri atëherë. Profesorët nga Shqipëria sollën në Prishtinë filmin "Skënderbeu" dhe disa relike të tij. Një natë para se të fillonte simpoziumi në teatrin e Prishtinës u dha një shfaqje teatrale për Skënderbeun. Rolin e heroit tonë kombëtar e luajti për mrekulli Hasan Salaj. Në oborrin e fakultetit bashkë me disa studentë tjerë biseduam me profesorët nga Shqipëria. Ishin shumë të përzemërt, sidomos Aleks Buda. Vlen për t'u shënuar se intervista e Dr. Athanas Gegaj dhënë Zërit të Amerikës u dëgjua në atë kohë me shumë vëmendje sidomos nga familjaret e tij në Malësi të Madhe në Mal të Zi. Trieshi qe është vendlindja e Dr. Athanas Gegaj e nderoi heroit tonë kombëtar në mënyrë të posaçme me rastin e 500-vjetorit të vdekjes, duke i dhënë shkollës tetëvjeçare emrin Gjergj Kastriot-Skënderbeu që e mban me guxim e respekt për gati një gjysmë shekulli, pavarësisht kërcënimeve të ndryshme. Kështu veproi edhe Ostrosi i Krajës në Mal të Zi, mbasi edhe ata para një gjysmë shekulli e pagëzuan shkollën e tyre Gjergj Kastriot. 500-vjetori i vdekjes së Kastriotit solli një ringjallje të vërtetë kombëtare në trojet tona te pushtuara nga sllavët e Ballkanit.

Gjekë Gjonlekaj

AIDSSH, INSTITUCIONI MË I RI SHQIPTAR PREZANTOHET PARA SHQIPTARËVE TË BELGJIKËS

Autoriteti për informim mbi dosjet e ish sigurimit të shtetit, zhvilluan një veprimtari me shqiptarët e Belgjikës në Bruksel. Një ekip i AIDSSH (autoriteti për informim mbi dosjet e ish sigurimit të shtetit), i përbërë nga zonja Gentiana Sula, Simon Mirakaj, Skënder Verioni, Ardita Repishti, Marengelen Kasmi, Altin Hoxha, në bashkëpunim me tre shoqata shqiptare në Belgjike, ish të përndjekurit

politik, Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Evropian, shoqata e shkrimtareve shqiptarë në Belgjike.

Në fillim, të pranishmit i ka përshëndetur zoti Lek Pervizi, ish kryetar i shoqatës së përndjekurve politik, i cili i ka përgëzuar grupin e këtij institucioni për të identifikuar terrorin e ushtruar nga ish siguri mi i shtetit shqiptar, për të gjithë ata që kanë vuajtur nga ky regjim, duke falënderuar për punën e bere deri tani dhe informimin e publikut të gjere.

Nga Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Evropian ka përshëndetur Sulejman Gjani, i cili ka ngritur shqetësimin se arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme po dëmtohet dhe mjaft dosje mbesin pa u zbardhur. Të pranishmit i ka informuar kryetarja Gentiana Sula, e cila ka shpjeguar

se si funksionon ky institucion, metodiken që ndjeket dhe punën e bere deri tani në identifikimin e dosjeve të ish sigurimit të shtetit. Për punën e bere deri tani duke eksploruar 2, 3 km arkiva, paraqitja e të dhënave dhe fakteve, puna shkencore duke marr përvojën gjermane, pasqyrimi i realitetit shqiptar. Ekipi i autoritetit beri një vizite në shtëpinë e zotit Lek Pervizi ku u njohën me punimet origjinale të vizatuara me dore në kampin e internimit në Tepelenë.

Me mjaft interes për publikun ishte shpërndarja e formularit të aplikimit për kërkues për qëllime kërkimore-shkencore. Gjatë këtij aktiviteti u bë dhe promovimi i librit "Rrëfime të Bashkëkohësive" të zotit Eden Babani, për të cilin

publicisti i njohur Agim Gjakova foli për punën shume vjeçare të autorit të librit, që në veçanti, me një pune këmbëngulëse shumëvjeçare ka paraqit jetën e emigracionit shqiptar në Belgjike dhe botimi në shtypin periodik shqiptar.

Autori Eden Babani iu dhuroi të pranishmeve librin e tij të fundit në fushën e publicistikës. Është ky libër, që paraqet komunitetin shqiptar nga të gjitha trojet shqiptare punën e bërë për ruajtjen e gjuhës shqipe dhe traditave më të mira të trashëguara deri në ditët e sotme nga emigrantët e ardhur, që punojnë dhe integrohen në kryeqytetin e Evropës.

Në fund, për të pranishmit, autori i librit shtroi një koktejl.

Përgatitur nga Zef Nika



LAZËR STANI: LETËRSIA SI DIALOG I BRENDSHËM NË ORËT E VETMISË

INTERVISTË E DHËNË GAZETARES VIOLETA MURATI

- Njeriu i dosjes, Dënese në dru, Koha për nuse... janë titujt e parë që më vijnë në mend sapo përmendet emri yt, si tregimtar. Kur kjo ngulitje bëhet e natyrshe, çfarë do të thotë për një shkrimtar, pavarësisht se të tjerë tituj janë lënë jashtë, ndoshta edhe të rëndësishëm për ju si autor.

Gjithmonë është kënaqësi për shkrimtarin kur dikush mban mend diçka të lexuar prej tij. Qoftë ky edhe një lexues anonim, i panjohur për ty, që jeton diku larg, që as e ke takuar dhe as do ta takosh kurrë. Nëse një libër, disa tituj librash, apo edhe një tregim i vetëm mbetet në memorien e lexuesit, shkrimtari ndihet i përkëdhelur. Se në kohët intensive që jetojmë, pothuajse 98 për qind e librave që botohen, harrohen brenda dhjetë viteve të parë.

"Njeriu i Dosjes", që ju e përmendni, është botuar 30 vite më parë, në korrik të vitit 1989. Pra ka mbijetuar për tridhjetë vjet në kujtesën e lexuesve, në kujtesën e studiuesve, të kritikëve të gazetarëve të kulturës.

Libri im i parë, i botuar në vitin 1993, nga Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, që drejtohej nga shkrimtari Zija Çela, nuk gjendet më askund, edhe pse u botua me një tirazh prej katër mijë kopjesh. Një ditë një lexues nga Mirdita më çoi të fotografuar kopertinën e këtij libri, që e ruante në bibliotekën e tij personale. U ndjeva vërtetë mirë. As librat e tjerë, nuk gjenden në treg përveç dy botimeve të fundit, "Kohë për Nuse" i ribotuar nga Enti Botues Fishta dhe "Rrugë pa krye", që është botimi im i fundit me esë letrare. Edhe pse leximi dhe tregu i librit janë futur në një krizë dramatike, prapë ribotimi i librit tre vite pas botimit të parë, përbënte një ngjarje letrare për mua. Një libër që fiton çmimin e lexuesit, ka fituar çmimin më të madh. Aq më tepër që letërsia që shkruaj unë nuk ka asgjë të përbashkët me atë lloj letërsie që njihet si best-seller.

Personaliteti juaj, në fakt, është disi i tërhequr, ndonëse me angazhime, aktiv në daljet publike e debate politike. Nuk e kërkon protagonistizmin, aq më pak në letërsi... është çështje besimi, apo ka diçka që nuk shkon me lirinë?

Të shkruarit, krijimi, është një akt shumë personal, proces i një vetmie të thellë, kur ti je vetëm i rrethuar nga katër muret e heshtur të studios tënde. Është një akt i shenjtë që nuk bën as të përflitet dhe as të përgojohet. Edhe kur rri me miqtë e mi shkrimtarë, poetin Bardhyl Londo, shkrimtarin, Zija Çela, poetin Visar Zhitë, apo poetin Agron Tufa, rrallë flas për letërsinë. Letërsinë më shumë e kam dialog të brendshëm me veten në orët e vetmisë, në orët e pagjuma. Aty zënë fill edhe krijimet e mia. Qëndrimi i tërhequr, ngujimi në kullën tënde, nuk është akt mosbesimi. Unë nuk di të ketë besimtarë

më të mëdhenj se sa murgjit që mbyllen në manastire. Nga ana tjetër shkrimtari komunikon me botën nëpërmjet librave të tij. Nëse librat nuk arrijnë të komunikojnë, atëherë përpjekja për të komunikuar nga tribunat, nga ekranet e televizioneve, nga portalet apo gazetatat është një për-



pjekje e dështuar. Unë nuk bëj pjesë ndër ata shkrimtarë që rrinë duke bërë titur "Unë Jam Shkrimtar!". Një protagonistizëm i tillë më duket i pakuptimtë, madje i dyshimtë. Ndoshta vjen nga dyshimi që bren nënvetëdijen tënde krijuese se librat e tu janë të përkohshëm, të harrueshëm, të papërfillshëm nga lexuesi.

Madje nuk kam organizuar kurrë një promovim libri. Nuk mund të organizoj një spektakël, ku disa prej miqve, flasin mirë për librin tim, sipër një nuse të sapozbuluar nga duvaku dhe që u kërkojnë të pranishmëve, miq dhe dashamirë të tutë, ose adhurues të letërsisë, që të blejnë e të lexojnë librin tënd. Mbase jam i gabuar, por një imponim i tillë më duket i pamoralshëm.

Natyrisht, kam marrë pjesë kur kam qenë i ftuar në takime të ndryshme me nxënës shkollash, studentë, apo konferenca e takime të organizuara nga bashkitë, shoqatat, bibliotekat.

-Për ta vazhduar pyetjen e mësipërme, shpesh kur shohim shkrimtarë apo intelektualë të çdo fushë të përfshirë në politikëna duket sikur diçka humbet nga personalitetit i tyre... mendoni se kjo është një rast, precedent nga e shkuara jonë komuniste,

apo sot ky nivel nuk kryen akte, apo merr përsipër kauza të polisit - qytetit, qytetarëve? Së paku në reflektimin mbi kulturën, politikat kulturore në vend. Si e shpjegoni?

Kur shkrimtarët ftohen në politikë, natyrisht që ftohen për nevojat e politikës,

janë aktivë në politikë si deputetët Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, apo Faik Konica, Fan Noli e shumë të tjerë. Mendoj se nga pjesëmarrja e tyre në politikë ka përfituar Shqipëria, jo ata vetë.

Shkrimtari, si qenie njerëzore, ka ndjeshmëri të lartë ndaj lirisë, padrejtësisë dhe vlerave humane. Pjesëmarrja e shkrimtarëve në politikë i rrit këto sensibilitete, e bën politikën më humane, nëse ai vërtetë, duke qenë i pranishëm në politikë, e shpall identitetin e tij dhe nuk bën kompromis me vlerat në të cilat beson. Pra nuk ka asgjë të keqe që shkrimtari të jetë pjesë e proceseve politike, përkundrazi është një investim për shoqërinë së cilës i përket, jo për atë vetë. Të mos harrojmë se një nga politikanët më të shquar shqiptarë të shekullit të njëzetë, Ibrahim Rugova, vjen nga bota e letrave.

Natyrisht imazhin e keq të shkrimtarit në politikë, e krijoi diktatura nga përdorimi i përdhunshëm që u bëri disa shkrimtarëve.

-Keni thënë se çlirimi nga tabutë, është një hap drejt lirisë në përgjithësi dhe lirisë krijuese në veçanti. Por, edhe ky proces është kaq i ndërlikuar... çfarë keni pasur parasysh me këtë?

Julio Cortazar në librin e tij të njohur "Rreth ditës në tetëdhjetë botë" shkruan se "të gjithë shkrimtarët europianë janë bërë të bapizmit të tyre; nëse mund të parafrazoj Rimbaud-in, na pëlqen ose jo, të shkruarit e tyre mbart bagazhin e një tradite të madhe, pothuajse të frikshme; e pranojnë këtë traditë apo luftojnë kundër saj, ajo jeton brenda tyre, është familjarja dhe sukuba e tyre". Pra tradita e fuqishme nganjëherë kthehet në tabu penguese për shkrimtarin. Tabutë e tjera, janë më pak penguese, më pak të përfillshme nëse kemi të bëjmë me një mendje krijuese. Dhe një mendje krijuese, nuk mund të jetë ndryshe veçse një mendje e lirë. Kur fillojnë kufizimet, autocensura, frikërat nga tabutë, procesi krijues meket, liria krijuese shuhet.

Ne, ndërkaq, nuk kemi një traditë aq të fuqishme, sa ta skllavërojë shkrimtarin e sotëm shqiptar, pavarësisht arritjeve të letërsisë shqipe në historinë e saj. Përkundrazi, ajo është inspiruese. Natyrisht edhe shkrimtari është njeri dhe si njeri ka kufizimet e tij, kufizime që shkrimtari nuk mund t'i dallojë vetvetja. Ne nuk mund të jemi më shumë se vetja jonë në letërsi, se vetja jonë më e mirë, që jeton ndoshta edhe si e panjohur brenda nesh.

-Të shkruash kur ke diçka për të thënë – duket se kjo është linja e tregimeve që keni botuar, pasi mesa ju kemi ndjekur, librat e tu janë moment, si një kohë e caktuar. Është ideja e intensitetit të krijimit, kur...?

Nuk e kuptoj se si mund të shkruash kur nuk ke asgjë për të thënë. As të flasësh nuk flet dot nëse nuk

ke diçka për të thënë. Ndryshe të shkruarit kthehet në sindromë, të folurit në ves. Të shkruarit të shkrimtari vjen natyrshëm, në mënyrë befasuese. Ti je rrugës duke ecur dhe papritmas e gjen veten brenda një historie, ose ndodhesh i shtrirë në shtrat, duke u përpëlitur në orët e pagjuma dhe papritmas rrëmbehesh nga një frazë, nga një histori, nga një rrëfim, nga një subjekt... Unë nuk mbaj kurrë shënime. Nuk e di nëse është e mirë apo e keqe mosmbajtja e shënimeve, por me vete kam menduar se ato histori që harrohen nuk meritojnë të shkruhen. Diçka që nuk mbijeton brenda meje, vështirë se do të mbijetonte te lexuesi. Ndodh që disa tregime, apo subjekte i kam mbajtur disa vjet në mendje, pastaj në një moment të dhënë jam ulur dhe i kam shkruar me një frymë. Si tregimin "Daiza Zaharia" për shembull, botuar në librin "Kohë për nuse". Ka një distancë të madhe midis asaj që krijohet brenda teje dhe tekstit të shkruar. Shkapërcimi i kësaj distance jo gjithnjë është i mundur. E pashkruara gjithmonë është më shumë se ajo që ke shkruar dhe publikuar dhe kjo e bën procesin e krijimit të pandalshëm.

-Ndoshta jeni nga të rrallët shkrimtar që ndiqni "gjithë jetën" një zhanër: tregimin. Ju vini nga një formim jo letrar, por besojmë se ka një shkak, nxitje të hershme pse sot ju quajmë shkrimtar. A keni një histori, zanafillë qëiu përcaktoi të tillë?

Shkrimtari nuk bëhet nga shkolla, shkrimtari lind. Mund të bësh të gjitha shkollat, të jesh njeri shumë i ditur, por nuk je shkrimtar. Shkolla në rastin më të mirë të shkurton rrugën midis shkrimtarit të lindur dhe shkrimtarit të realizuar. Është si njëllor hartorientuese që të shpëton nga sorollatjet e pafundme në pyll. Unë në fakt, doja të studioja për letërsi, por asnjëherë nuk m'u dha kjo mundësi. Tani e konsideroj fat që studiova në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në degën e Biologji Kimisë. Ishte ndoshta ndër të paktët fakultete, ku merreshin dije të pamanipuluar dhe ushtrime të menduarit konceptual. Aq më tepër që unë i doja shkenat, fizikën, kiminë, biologjinë. Ndërsa Fakulteti i Letërsisë, për fat të keq, ishte një fakultet doktrinar, jo shkencor. Dijet e mia për letërsinë i kam krijuar nëpërmjet leximeve të shumta, në mënyrë autodidaktike, krejt i pandikuar nga shkolla zyrtare, metoda sunduese, propaganda letrareske, kritika e indoktrinar. Në lirinë që të krijon leximi, refuzon gjithçka që nuk pranohet natyrshëm prej teje dhe pranon atë që krijon harmoni me ty, me shpirtin tënd. Dhe që herët kam shkruar, por vetëm për vete, pa i ndarë me askënd shkrimet e mia. Kur më mërzhiteshin i grisja të gjitha dhe pas një kohe bukur të gjatë, ndoshta pas disa vitesh, gjithçka rifillonte nga e para. Më kujtohet se si student, dërgova një tregim në gazetën "Studenti". Ngjarjet e tregimit i kisha vendosur në një nga republikat balltike, në Letoni, më duket. E lexuan tregimin dhe vendosën të mos e botonin, ngaqë menduan se tregimi duhej të ishte i përkthyer nga ndonjë autor i huaj. Unë u gëzova shumë kur mësova se çfarë kishte ndodhur. Ata nuk e besonin, se një student i Shkencave të Natyrës, krejt i panjohur në letërsi, mund të shkruante një tregim të tillë. Pra sipas mendjes së tyre

unë me siguri e kisha përkthyer, ngaqë e dinin se zotëroja mirëdisa gjuhë të huaja. Por akuza e tyre e marrëme dha shumë siguri te vetja, pavarësisht se tregimi nuk u botua kurrë dhe një ditë nuk e di se ku e humba. Edhe pse disa vite nuk u mora më me shkrim letrar. Tregimin e parë të publikuar, e shkrova pas disa viteve, mbi një tabak letrë, ndërsa bëja dëzhurnin e detyruar në shtypshkronjën ku shtypej gazeta në të cilën punoja. Tregimi quhej "Emri im i bukur". Pak narcisit apo jo. Pas disa ditësh shkrova tregimin "Mara nuk është e qartë", tregim që u botua në gazetën "Zëri i rinisë" dhe pati një pritje shumë të mirë midis kolegëve. Një kolege e quajti tregimin më të mirë të botuar në letërsinë shqipe në dyzet vjet. Natyrisht e tepronte. Kur botova librin e parë unë nuk e përfshiva këtë tregim të hershëm. Më dukej seai tregim kishte një farë ndikimi të padukshëm nga Çehovi, kështu që e lashë jashtë librit. Doja dhe dua që në letërsinë time të jemvetëm unë, askush tjetër.

Ndërkaq, vërtet, kam botuar vetëm libra me tregime, por kjo nuk do të thotë se nuk shkruaj edhe gjera të tjera.

-Vazhdon të jetë një kujtesë e çuditshme, për shkrimtarët shqiptarë-gazeta "Drita", që pushoi së ekzistuari pas '90-ës, me rënien e diktaturës. Ka nostalgji për të, ju si e kujtoni botimin aty?

Gazeta "Drita", megjithë censurën e kuptueshme për atë kohë, ishte gazeta më e rëndësishme për inteligjencën krijuese dhe shumë e dashur për lexuesit. Tregimin e parë në atë gazetë e kam botuar në vitin 1988. Tregimi titullohej "Fundi i shëtitjeve natën". Vite më vonë, Luljeta Lleshanaku më ka treguar se kur e kishte lexuar atë tregim, i ishin mbushur sytë me lot. Nuk i kishte ndodhur të lexonte kurrë në shtypin shqiptar një tregim aq të dhimbshëm për dramën e individit, dramën e njeriut në shoqëri. Dhe mua, siç më ka treguar pasi u njohëm, më kishte përfytyruar si një burrë dikund rreth të pesëdhjetave dhe shumë kurajoz që guxonte të shkruante gjëra të tilla. Kur u prezantua rastësisht një vit më vonë, mbeti e habitur që ai flokëthinjuri pesëdhjetë vjeçar, ishte një djalë dikund rreth të tridhjetave.

Me Bardhyl London, mikun tim, prisnim sezonin e pushimeve që të botonim krijimet tona në gazetë. Pra kohën kur të mëdhenjtë thyenin qafën plazheve dhe ne ndjeheshim pak më të lirë. Kështu vepruam me Bardhin në gusht të vitit 1989. Ai botoi poemën e tij të njohur "Ditë njerëzore", ndërsa unë tregimin "Orët e pagjuma". Arshi Pipa, si një vëzhgues i vëmendshëm i procesit letrar shqiptar, e komentoi poemën e Bardhit te Zëri i Amerikës, duke ia komplikuar disi situatën. Ai nëpërmjet botimeve në fundin e viteve tetëdhjetë, parathoshte atë që do të ndodhte vetëm një vit e gjysmë më vonë: hapjen e Shqipërisë ndaj proceseve demokratike.

Ama me Bardhin kam një histori të bukur. Në vitin 1990 i dërgoj një tregim me titullin "Margaritarët" tregim, që e kam botuar në librin e parë. Pasi e lexoi më tha se tregimi do të botohej të dielën e ardhshme. Pas disa ditësh më merr në telefon e më thotë të shkoja ta takoja:

"Nuk mund ta botoj tregimin se është

pornografik e na merr në qafë të dyve. Guacka që përshkruan në tregim është metaforë e seksit të femrës."

"Kush drej femre e paska lexuar se ty me siguri nuk do të shkante mendja për këtë," i thashë.

Pimë kafe bashkë dhe i premtova se herën tjetër do i dërgoja një tregim të tre dhur, pa seks. Bardhi u shkri së qeshuri.

Pastaj më takoi të punoja tre vite në gazetën "Drita", 1991-1993. Mendoj se kanë qenë vitet më të mira të kësaj gazete në historinë e saj. Tirazhi shkante mbi njëzet mijë kopje. Ne nuk kishim letër, por kërkesa e tregut ishte edhe për më shumë. Natyrisht, kohët kanë ndryshuar dhe sot nuk e kemi më një gazetë të tillë.

-Nga lindin historitë, çfarë trazon në ju lënda letrare në raport me realitetin, idetë? (mund të sjellësh edhe shembuj konkretë)

Përgjigjen më të mirë më duket se e ka dhënë Brodsky kur e pyetën në gjyq se nga i vinte poezia: "Mendoj se kjo vjen prej Zotit", tha. Pikërisht për këtë, letërsia, krijimi, arti në përgjithësi ka diçka hyjnore dhe si rrjedhim, diçka të pashpjegueshme në vetvete. Nuk bëhesh shkrimtar se ke dëshirë të bëhesh, se e mëson zanatin në shkollë, se i vë detyrë vetes të shkruash. Gjithçka është e lindur brenda teje, vjen natyrshëm, si një befas, si një zbulës. Ndodh që të shfaqet nëndërr si një fat i parathënë, kur je duke udhëtuar me tren së bashku me qindra pasagjerë të panjohur, je duke shëtitur vetëm në pyll, apo bredhur pa asnjë qëllim në kokë anës lumit. Ose mua më së shumti më ndodh në orët e pagjuma, në qetësinë e thellë të natës, kur përpëlitesh në shtrat me gjumë të arratisur. "Korbat", për shembull, jam ngritur nga shtrati në mes të natës dhe e kam shkruar për një çerek ore. Kur kam shkruar "Margaritarët" mbaj mend se isha i sëmurë keq me grip. Dola në koridor, nxorra një tryezë aty, dhe i mbështjellë me batanie, e shkrova brenda një pasditeje. Ose një nga tregimet e fundit që kam shkruar "Diçka i mungon asaj gruajë". Rilexova tregimin tim "Rruga e Pyllit". Ndieja se diçka i mungon atij tregimi. Mora e dhashë me veten se çfarë pikërisht i mungonte, por për shumë e shumë ditë nuk e gjeta. Atëherë pikërisht për këtë shkrova një tregim tjetër të shkurtër, që tani gjithsesi e dua. Pra nuk ka as shpjegim bindës se nga vjen dhe pse shkruhet një tregim. Thjesht ndodh.

-Tregimi "Njeriu i Dosjes" nga krijimet e tua më të hershme, thoni se e keni shkruar me menjë frymë, një mbrëmje marsi, të 1989. Mund të themi se ishte një tregim "i parakoshëm" për dosjet, që tronditi jo pak njerëz. Kujtojmë se Arshi Pipa i ka bërë dhe një analizë letraro-politike...S'ka qenë e lehtë në ato fillime të hyje si shkrimtar "politik", ndonëse jeta juaj letrare shpesh është dyzuar në këto vite. Çfarë kujtoni nga kjo histori sot?

Nuk jam shkrimtar politik, asnjëherë nuk e kam patur një qëllim të tillë. Por koha në të cilën u botua tregimi i dha atij një kontekst të fortë politik. Për këtë kam shkruar dhe një esë të gjatë të botuar në librin "Rrugë pa krye". Arshi Pipa i bëri një lexim të fortë politik, por unë mbi të gjitha them se është një krijim letrar. Është kjo arsyeja që më nxiti të shkruaj dhe një

esë të gjatë për këtë temë.

-Tregimet tuaja, priren nga njeriu ekzistencial, dilemat, çfarë është natyrë burimore, origjinare e jetës vendase, lokale...Shumë besojnë se universalizmi në letërsi s'ka punë me lokalitetin, ju si e mendoni ç'kontekste përfshin sot letërsia?

Nuk ka letërsi lokale, krahinore, fshatare, qytetare, femërore, mashkullore. Edhe klasifikimet që bëhen nga shkollat letrare janë tepër të dyshimta, kanë theks të karakter didaktik, ndaj kurrë nuk i kam marrë seriozisht. Megjithatë këtu krijohet gjithmonë një keqkuptim i madh, sidomos te shkrimtarët e rinj, që duan me patjetër të bëhen të mëdhenj, të rrokin tema universale. Ernesto Sabato, në një bisedë, duke iu drejtuar shkrimtarëve të rinj, pyeste: A do të bëhesh shkrimtar apo i famshëm? Dhe shtonte: "Se fama dhe shkrimtari nuk janë e njëjta gjë."

Mua më kujtohet një lexuesi im, shumë dashamirë, por pak naiv: "Shiko më thoshte, shkrimtarët e mëdhenj merren me personazhe të rëndësishëm të historisë: Homeri merret me heronjtë e Lashtësisë, Shekspiri me mbretër, Ismail Kadare me ministra, sulltanë, kryetarë shtetesh." Mua më vinte për të qeshur me këtë këshillë, por për mirësjellje kafshoja buzën, qëndroja serioz dhe e dëgjoja gjithë vëmendje.

Të ndjekim logjikën e kundërt: një nga tregimet më të bukur dhe më universale që kam lexuar në jetën time është "Gimpel Idiotti" i Isaac Bashevis Singer, edhe pse personazhi është një djalë gjysmë i metë, i vonuar. Arëmatësi i "Kështjellës" së Kafkës është një nëpunës i rëndomtë i shtetit, por mbetet gjithashtu një ndër veprat më universale të shkruara ndonjëherë. Sepse vetë njeriu si qenie, pavarësisht nga lokaliteti ku banon, pozicioni në shoqëri, shteti ku jeton, nacionaliteti të cilit i përket, gjuha të cilën flet, është një qenie universale. Brenda një individi të vetëm është i kondensuar i gjithë universi. Të paktën unë kështu mendoj.

-Keni ribotuar librin me tregime "Kohë për nuse", ku fëmijëria krijon tharme rrëfimesh. Çfarë më bën përshtypje është se librat më të mirë të shkruar nga autorët tanë, burojnë pikërisht nga këto histori të fëmijërisë...ç'është kjo "moshë"për ju, apo ka idealizim?

"Gjithçka është krenim në kopshtin e egër të fëmijërisë", shkruan në njërën nga poezitë e tij, Pablo Neruda. Itillë është edhe kopshti i egër i fëmijërisë time, një krenim që nuk mbaron. Pikërisht për këtë fëmijëria është shumë e pranishme te secili autor. Duket se dalja nga fëmijëria është si një arratisje nga parajsja në të cilën nuk mund të kthehesh më kurrë: Në një farë mënyre fëmijëria ime ka qenë shumë e begatë, e populluar me njerëz shumë të veçantë, me ngjarje, histori, ndodhi, rrëfime pafund. Pastaj si fëmijë me imagjinatë, zotëroja aftësinë për t'ia begatuar fëmijërinë vetes, pavarësisht kushteve të vështira në të cilat u rritëm. Këtë aftësi e ruaj edhe sot e kësaj dite, aq sa vetë fëmijëria ime më ngjan si *fiction*.

-Natyreshëm flasim për Dukagjinin tënd... Arketipi juaj në letërsi a merr, a buron prej andej?

Unë kam lindur në Dukagjin,

CURRAJ i EPËR VETËZBULOI VIRG JËRINË DHE HIRET E VETA RREZATUESE ALPINE

(Vijon nga numri 185)

Curraj i Epër, vëlla siamez, i lidhur me një kërhizë me Thethin, shpinë për shpinë me Valbonën, ndërsa më Vermoshin i bashkon e njëjta telepati natyrore. Bukuroshi i fjetur i bjeshkëve tona, gjendet në vazhdimin fundor të pellgut të Nikaj Merturit, i rrethuar vullshëm nga male gjigante, mbi 2000 metër, që formojnë njësinë më të fuqishme të Apërve lindore dhe nga më të mëdhatë e më të egrat e krejt maleve shqiptare.

Curraj i Epër gjeomorfologjikisht përfaqëson një luginë më forme govade me tiparet e një amfiteatri madhështor me drejtim nga VP-JL. me arkitekturë tipike të epokës së kuaternarit Luginë kufizohet në fund, në anë të majtë me majën Bosh (në VP 2416 m)¹, e cila ngrihet në formë kupole duke formuar

¹ Gjeografia fizike e Shqipërisë. Botim i Akademisë së Shkencave. Qendra e studimeve Gjeografike Tiranë 1991, fq 79 (lartësitë e maleve janë marrë nga i njëjti burim)

aty jam bërë katërmbëdhjetë vjeç. Kam jetuar aty dhe tre vite të tjera, pas mbarimit të shkollës së mesme, ndërkohë që prisja të vazhdoja studimet e larta. Them se Dukagjini ka qenë biblioteka ime e parë e madhe, më e pasura që mund të ekzistonte. Sot ai Dukagjin i projektuar brenda meje nuk ekziston më, siç nuk ekziston më ai Dukagjin, që na e sjellë në librin e saj "Majat e Shalës" Rose E. Lane. Kur lexova për herë të parë librin e Lane, më dukej se unë po e zbuloja Dukagjinin, që nuk e kisha njohur, edhe pse isha lindur e rritur aty. Pas gjashtëdhjetë vitesh, unë njihja një Dukagjin tjetër, që gjithashtu ishte magjepsës. Dhe tjetër është Dukagjini që njohin vajzat e mia, por që mbetet gjithashtu magjepsës dhe shumë i dashur për to. Dukagjini ndryshon nga dhjetë vjeçari në dhjetë vjeçar, por duket semagjepsjen e ruan të përjetëshme.

-Si e krijon njeriu lirinë, çfarë të ka bërë të lirë, sepse duket së paku tek ti si një ide "arratisje", ikje...apo?

Në anë të mia, pleqtë e shtrirë në shtratin e vdekjes, para se të jepnin frymën, u thoshin të gjallëve qëpo linin pas: "Po ju la të lirë e të bekuem." Kjo ishte trashëgimia më e madhe që plaku i shtëpisë mund t'u linte të gjallëve: Lirinë dhe Bekimin e Zotit. Them se kjo shprehje duhet të jetë shumë e vjetër, vjen nga kohët e lashta të pushtimeve të gjata. Por Dukagjini në vetvete nuk ishte pushtuar kurrë nga asnjë pushtues, ishte bërë si një strehë për njerëzit e lirë, ku, siç thuhet, erdhën edhe të parët që themeluan fshatin tim, aty nga fundi i shekullit të shtatëmbëdhjetë. Ndoshta kjo ndjenjë e fortë për lirinë u ngulit fort tek unë në mënyrë të pavetëdijshme, edhe pse linda në një kohë të keqe për lirinë. Dhe njeriu që është lindur me lirinë, që është rritur bashkë me të, nuk mund të heqë dorë kurrë prej saj.

- Për të shkruar letërsi të mirë a duhet të jesh "martir", në kuptimin e vetsakrifikimit?

ngjyrën hidrografike, trekëndorë mes lumenjve të Nikajve, Shalës dhe Valbonës. Në lindje Grykat e Hapta (2625m lartësi) dhe masivi që të drejton në majën konike të Hekurave (2561 m), ka më shumë pamjen e një blloku të fuqishëm që ngrihet vertikalisht mbi luginën e Currajve. Në përfundim ngrihet vargu pak më i ulët i Çardakut të Kakisë (1853 këtu gjendet edhe një nga shpellat më interesante e Kakverrit) që zbret deri në Rrasën e Currajve duke formuar ujëndarësin e lumit të Currajve dhe Nikajve Në VP të luginës dhe në faqën lindore shfaqte në mënyrë të dukshme morfologjia akullnajore me cirqe të shumtë në formën e lugjeve që zbrasin shkallë-shkallë dhe shënojnë filimin e degëve të lumit të Plasë. Luginë e përroit të Plasë nga ama e saj mes Kakisë dhe Derzave të Boshit, vijon deri te pragu i Drelës, në hyrje të fshatit, duke përshkuar formacionet rreshpore. Ndërsa në dalje të fshatit, luginë lumore pagëzohet me emrin (Curraj) e cila në

Unë nuk e konsideroj veten një martir të letërsisë. Megjithatë të merresh me letërsi, sidomos në këtë kohë, është një sakrificë.

-Çfarë ke kërkuar përmes shkrimit, letërsisë?

Sikur ta dija! As unë nuk e di përgjigjen. Thjesht ndodhi, por jo se kam kërkuar ndonjë gjë të veçantë.

- Po artikullohet së fundi mendimi, se po bëhen shkrimtarë pa libra (në kuptimin e një letërsie të nivelit të dobët) ku shpjegohen shumë arsye të tjera rrjedhëse, pse nuk lexojnë letërsinë shqipe...

Më duket një proces normal. Gjithmonë kështu ka ndodhur. Shkruhen me mijëra e miliona libra, qindra mijëra botohen, por gjithnjë meskësaj ushtrie të pafundme shkruesh shfaqen edhe shkrimtarët, poetët. Por mendoj se kjo nuk është arsyeja pse nuk lexohet letërsia shqipe, e cila ka autorë shumë seriozë dhe libra shumë të mirë botohen çdo vit. E vërteta është se ka një tëhuajësim me librin, një keqeducim me leximin: në familje, në shkollë, në shoqëri. Prindërit u blejnë fëmijëve dhjetra dhurata të shtrenjta për ditëlindje, rroba, këpucë, Iphone e ku di unë, po sa prej tyre i blejnë fëmijës një libër për ditëlindje? Po të bëhej një sondazh në shkollë shifrat do të dilnin të papërfillshme. Ndërkohë që libri do të ishte dhurata më e mirë. Janë ndërtaur më qindra mijëra shtëpi të reja, vila të bukura, apartamentë luksozë, po sa prej tyre janë të pajisur me një bibliotekë. Vërtetë prindërit e zellshëm po u trashëgojnë fëmijëve prona e pasuri, por jo pasurinë më të madhe për njeriun, kulturën.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shkollën në të gjitha ciklet e saj, e cila më shumë se edukon, keqeducon leximin. Pastaj më ka bërë përshtypje në panair: shumica e botuesve, afishojnë dhe reklamojnë autorët e huaj, të nxitur nga fitimi, dhe jo autorët e tyre shqiptarë, edhe kur janë autorë shumë seriozë. Shtu këtu dhe

mënyrë të detyruar ngushtohet nga formacionet solide karbonatike, duke formuar pragun e dytë dhe duke marrë pamjen e një kanioni (*Shkëmbi i forcës*). Arterja kaltëroshë vijon të meandrojë mes karbonatikëve deri sa bashkohet me luginën e Kuçit. Mbas bashkimit formohet luginë e vetme e Currajve e cila ruan tiparet e një "V" -je të gjerë e të thellë deri në hyrje të fshatit Curraj i poshtëm. Aty mbushet me frymë, lirohet duke çarë lehtësisht formacionet rreshpore, zgjeron shpatullat duke formuar zgjerimin e Lekbibajve. Këtu bashkohën dega e përroit të Nikajve që ka fillimet të burimet e Vranës dhe dega e Currajve duke formuar së bashku lumin e Nikajve me gjatësi 19 km dhe sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 145 km ka². Curraj Epër është një bjeshkë e

² Gjeografia fizike e Shqipërisë. Botim i Akademisë së Shkencave. Qendra e studimeve Gjeografike Tiranë 1991, fq 79 (lartësitë e maleve janë marrë nga i njëjti burim)

Gjeografia fizike e Shqipërisë. Botim i Akademisë së Shkencave. Qendra e studimeve

një politikë kulturore të dështuar dhe nuk ke se çfarë të presësh tjetër, veçse një braktisje masive të leximit të letërsisë shqipe.

-Tani që hapësira reale e shqipes, gjeografia është, pothuaj, dyfishuar. Kjo do të thotë treg më i madh për librin, mundësi më e madhe njohjeje, por nuk po ndodh kështu. Në të dy vendet Shqipëri e Kosovë, a mjaftojnë vetëm axhendat politike, sipas tyre për kalendare kulturore? (Rasti juaj, kritika nga Kosova ka folur më shumë mbi librat tuaj, se sa këtu në Shqipëri!)

Integritet kulturorë të të gjithë hapësirës shqiptare, janë të pashmangshme, jo për meritë të politikës, por si atribut i lirisë që kemi fituar në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, kudo ku jetojnë shqiptarë. Tregu gjeografikisht është zgjeruar, por hapësira e librit është ngushtuar për shkak të tëhuajësimit të njerëzve me librin. Si mund të shmanget ky impakt negativ? Kjo është një çështje, që kërkon vërtetë studim. Por mendoj se duhet një përmbyseje në mentalitetin tonë mbizotërues në këto vite nga institucioni bazë i familjes, e deri te intitucionet më të larta të shtetit.

-Në kontekstin e mësipërm, sa mund të shërbejnë panairët e librit, që duken si të vetmet mundësi konkrete, të integritit të përbashkët?

Panairët janë diçka pozitive, por gjithsesi të pamjaftueshme.

-Bashkë me poetën Luljeta Lleshanaku, bashkëshortja juaj, ju jeni dy individë që "luftoni" për të njëjtin territor. Si ka qenë jeta juaj, a ja dilet jetesa vetëm me librin?

Është një sakrificë sigurisht, por mendoj se secili krijues, ka territorin e tij të pafundmë, ka universin e tij, ku nuk mund të depërtojë askush tjetër. Një herë Luljeta pasi lexoi një nga tregimet e mi të shkurtër më tha: "S'më le vend. Ke hyrë në territorin tim. Ky nuk është tregim, është poezi."

"Në letërsi nuk ka tokë të xanun" iu

shkëlqyer panoramikë, si kurorë dafinash mbi kokën e pellgut të Nikaj Merturit. Malet e lidhur sup me sup, fusnin në kllapa luginën, puthën me kupën e një qielli kaltërosh, nën hijën e të cilave shtrihën livadhet e Rrajzave, Kodër Demirit, për të vijuar me lugjet paralele Lugu Zajkut, Boshit dhe Koritave. Duhën mbi dy orë ecje të thekshme në rrugë këmbësore nga qendra e Currajve deri tek ato kullosa të mbuluara me gjithfarë lulesh bukuroshe, që përbëjnë një minierë sa të pasur aq edhe të rrallë botanike.

Në JP të Currajve shtrihen rrafshnallta e lumnume me livadhe pa fund dhe burime përrallore të Pikut që është bukuria, mirësia, jetesa dhe krenaria e Currajve të Epër të mirënjohur si blegtorë të shquar. Livadhinat e Pikut që ngjasojnë me shtroja të papërsëritshme leshi dhe mëndafshi duke formuar një koleksion natyral tepër elegant, dhuratë e begatë e Krijuesit të gjithëpushtetshëm. Një mo-

Gjeografike Tiranë 1991, fq 81.

përgjigja unë dhe qeshëm të dy.

-Duke iu referuar se çfarë dëmi shkakton tek brezi i ri mosleximi, keni thënë se "po shkojmë drejt një shoqërie shpirtërisht të zbrazët, dhe intelektualisht të kufizuar"... A nuk është tepër e zymtë kjo qasje?

Më tregonte miku im Visar Zhiti se para disa vitesh në Itali sondazhet treguan se leximi i librit kishte rënë me dy për qind dhe u bë alarm kombëtar. Kam pyetur librarët këto ditë dhe më kanë thënë se shitja e librit në pesë vitet e fundit ka rënë me dyzet për qind. Pas këtij konstatimi pyetja që shtrohet është: ku po shkojmë? Natyrisht drejt një shoqërie shpirtërisht të zbrazët dhe intelektualisht të kufizuar. Por te ne askush nuk i tund kabanat e alarmit.

-Cilët janë shkrimtarët shqiptarë, që admironi dhe ndihen të rëndësishëm për ju? Kam parasysh se letërsia shqipe e '900-ës, nuk ka vetëm letërsinë e realizmit socialist, jemi më herët...

Kam dy autorë veçanërisht të dashur, Ernest Koliqin dhe Mitrush Kutelin. Ama e dua çdo libër të vjetër, Naimin që shkroi "Bagëti e Bujqësi" me një shqipe të kulluar, Fishtën për leksikon e jashtëzakonshëm, Kristoforidhin në një botim të papërpunuar gjuhësisht të vitit 1930 për shqipen e mrekullueshme. Dhe shumë tekste të vjetra këngësh Arvanite, arbëreshe, tekste të këngëve të vjetra të Veriut, Eposin.

"Fort po shndrin njaj diell e pak po nxen". Që në vargun e parë poeti anonim i së shkuarës, të ulë siparin e një tragjedie që pritet të ndodhë. Ka më bukur?

-Ç'duhet të dijë një shkrimtar i ri?

Shkrimtari nuk bëhet me këshilla. Asnjë këshillë nuk do të ishte e vlefshme. Them se së pari shkrimtari duhet të jetë një lexues i mirë. Nuk mund të bëhesh shkrimtar i mirë, nëse je lexues i keq. Dhe e dyta, them se shkrimtari duhet të jetë vetveja në letërsinë e tij. Pra mbathja menjëherë nëse e gjen veten në territor të huaj.

zaik spektakolar, i gjalluar nga lulet shumëngjyrëshe, plot reflekse xixëlluese qëndisin këndshëm ato shtroja të blerta të pashoqe. Drethet (luleshtrydhet), mje-drat, qershizat e egra(boronica), manaferrat selepi, xhirokulli dhe kërpudhat janë begati ngjyrash, aromash, shijesh dhe vlerash të bekuara për organizmin e njeriut

Përroi lumë, që ndanë në mënyrë simetrike dy faqet e luginës është arteria kryesore e kaltër me valë të argjendta që rrjedhë si uverturë e këndshme në blerinat e pashoqe alpine. Ujërrjedhja vjen e shtohet pasi mbledh me dashamirësi të gjitha krojet dhe burimet e prej gurrës së shpellës së lumit atë të Qereshit që gufojnë plot gjallëri prej strukturave karbonatike e flishore me shumicë. Edhe po qe statik si shkëmbi, nëse gjendesh në agim në atë breg, njëherazi me rënjen e rrezeve të diellit, kalon ylberin e bëhesh romantik, delikat. Çfarë pëshpëritë kjo valë e acartë, çfarë është kjo romancë elektrizuese që rrjedhë bukur në lëndina të panjohura të bjeshkëve të Currajve të Epër?! Ky lumë këndon e vallëzon, dhuron freski e njomë rreth 2500 ha vend edhe kur dielli zhegitë e skuq gjithçka. Ky lumë u jep madhështi prigrjeve, blerim bashtinave, gaz dhe jetë aheve e lisave që lëshojnë hije dehëse mbi të. Ujërat e bollshme që gjenden kudo administrohen në vada të gjalla të cilat përshkujnë të gjithë fshatin si damar të një trupi të shëndetshëm që ushqejnë e mbajnë njomë bimësinë e këtij vendi që edhe në pikun e verës shkëlqen plot gjelbërim.

Ky lumë i pastër shpesh është larë me gjak zaptishë të huaj që nuk mundën të ngulin kurrë këmbë në këtë fole shqipesh krenare.

Në breg të këtij lumi, afër kishës për karshi, në verë të viti 1915, Gjelosh Rama në krye të vullnetarëve të Currajt Epërm shkroi një epos qëndrese së bashku me Kukel Nduën, Sylë Avdinë, Mark Hasanin, Balec Gjonin. Në kushtrimin e në poterën e Currajve të Epër fluturuan edhe Prelë Tuli e Tunxh Myftari edhe Mark Sadiku e Shytan Brahimi edhe Mark Alia, Dedë e Sadri Trimi, edhe Nikë Musa e Zhujë Avdyli³. Ora e Nikajve, e remtë dhe idhtë si pika, shytë rrufeje prej Majës së Kakisë dhe i bani gjamën ushtrisë serbo-malazeze në Curraj të Epërm. *U bënë fli në këtë sfidë fatosat Nikë Delia, Sadri Trimi, Ali Haka, Sejdi Myftari, Gec Prendi, Kamer Prela dhe Zhuj Avdyli.*⁴

Curraj Epërm ka klimë tipike malore, me dimra të ashpër, me reshje të shumta bore dhe me verë relativisht të freskët. Temperatura mesatare vjetore lëkundet nga 8-11 gradë C dhe sasia mesatare e reshjeve 2763mm (Qeriq, Mulaj). Pjesa më madhe reshjeve të dimrit dhe pjesërisht ato të fund vjeshtës e fillim pranverës bien në formë bore. Nga reshjet e bollshme të shiut por edhe të borës niveli i prurjeve të lumit të Currajve është i lartë. Nga niveli i prurjeve gjeografet e kanë quajtur vëlla të Kirit dhe nga regjimi, tezak i Valbonës. Në këtë lumë, me

ujë si loti, jeton tofta pikaloshë, tipike e ujërave të ëmbla alpine. Trupi i saj është i mbuluar nga pika të kuqe të vogla me hije të gjelbër në kafe. Përmasat e saj variojnë nga 10 cm deri në 50 cm

Kjo luginë mbulohet nga një florë trekatëshe, që fillon me dushkun, domi-



non ahu e më pak pisha. Mbi brezin e ahut dhe të pishës si shami rrezedhitëse valëviten kullotat e pasura alpine. Këtu takohën bimë të periudhës akullnajore (*reliktet glaciale*) me bimë të shumëllojshme dhe interesante. Fauna e Currajve është e pasur dhe e larmishme, identike si e Thethit, Valbonës dhe Vermoshit, disa lloje gjitarësh, disa dhjetëra lloje shpendësh folenizues, zvarranikësh dhe amfibësh. Rëndësi paraqesin gjitarët dhe shpendët e lidhur me pyjet e larta dhe ekosistemet malore alpine. Ndër gjitarët më të mëdhenj të parkut janë: Ariu i murmë, ujku rrëqebulli çakalli, dhëpëra dhia e egër, kaprolli, derri i egër etj. Fshati shtrihet prajshëm në dy anët e kësaj luginë të mahnitshme, me 870-900 m mbi nivelin e detit. Tokat në të dy anët e lumit janë sistemuar me kujdes mbi atë litologji tarracore të formuar nga materialet e shumta kokuvo-deluviale. Shpatet kodrinore janë të veshura me gjelbërim, relievi aty - këtu përthyer me ulje e ngritje deri në lartësim në kreshta e curra të mprehtë duke krijuar një mozaik natyral madhështor plot ngjyra e shkëlqim që për disa muaj të vitit mbytet në një det kristalor bardhësie. Vera është një stinë shpërthyes dhe dorëlëshuar në bukuri. Bujaria e saj derdhet me hijeshi kudo në Curraj të Epërm duke sjellë gëzim për syrin dhe shpirtin e njeriut. Ajri i bjeshkëve, parfumi i lulëzimit, flladi i ahut, aroma e pishës janë ledhatimi, puthja dhe prehja ëndërrimtare e trupit dhe e shpirtit.

CURRAJ EPËRM NË KOMA I THOTË "JO" VDEKJES

Mbizotërojnë shtëpitë e gurta, kryesisht dy por edhe tre kate të larta, me qoshe të skalitura estetikisht me dekoracione iliro-paganë në harqet e dyerve dhe dritareve. Rrok Zojzi në ekspeditën e tij studimore në vitin 1956 ka skicuar dhe përshkruar banesën tipike alpine të Currajve të Epërm, ku si veçon shtëpinë e Plumb Marashit(muri, qoshet me gur të latuar, çatia me dy uja shumë të pjerrëta, mbuluar me dërrasë⁵. Të gjitha me çati piramidale prej dërrase pishe, me shkallë përjashta e krevate druri në të shkuarën. Banesat kanë formë drejtkëndëshi dybrinjëshëm, dy prej tyre përfundojnë me gungë në formë trekëndëshi dhe ngrihen në lartësi deri tek kulmi duke u dhënë hijeshi, madhështi dhe përshatshmëri fine me natyrën. Nga lartësitë e qafave përmbi, shtëpitë e Currajve ngjasojnë si koshere bletësh në miniaturë të shpërndara në blerim si yjet në qiellin pa re.

Rrezet e para të mëngjesit dhe drita e zbehtë e hënës janë vegim fotozhenik i pashoq për syrin e njeriut që nuk ngopet duke pa me lakmi. Në prag të viteve nëntëdhjetë të shekullit XX kishte rreth 150 shtëpi, të cilat fatkeqësisht për më se 25 vite kanë mbetë shkretë.

Në qendër të fshatit gjendet kisha që daton me vitin 1887 e cila i ka mbijetuar herezisë ateiste dhe asaj migrative. Aty pranë gjendet shkolla e vjetër prej nga kanë dalë filizat e shëndetshëm të mësuesve, inxhinierë, agronome, doktorë, veterinerë, oficerë, juristë dhe intelektual më profil të lartë shkencor me tituj e dekorata. Vatra që ushqete me dije breza të tërë nxënësish sot ngjason si koshere e një blete të braktisur. Në kontrast të thellë bashkëjeton pejzazhi i blertë më gjithçka të ndërtuar nga njeriu në rrënim pa fre. Braktisja e këtij vendi ka ndodhur për disa arsye: Shumica e Currajve kërkuan një jetesë më të mirë, shumë të tjerë kanë qënë të detyruar të largohen, pasi të gjitha qeveritë jo vetëm e kanë harruar por as nuk e dinë se ku ndodhet kjo mirësi e struktur në sqetullën e maleve, ndërkohë që hireve të tij i kanë kënduar që në fillim të shekullit 20-të Franc Nopça, Karl Steinmetz, Edith Durham, për të vijuar me At' Z. Valentini, At B. Palaj, Rr. Zojzi etj.

Në mes të fshatit, pranë urës që bashkon dy anët e lumit të Currajt, në lagjen Nikbibaj, gjendet shtëpia Kol Dedës. I ka mbetur emri "Kulla e Ngujimit", ku në fakt ka pas krejtësisht pamjen e një pingu këstjellë vendosur mbi një curr gëlqeror afërsisht 15 m e lartë, e cila thuhet se u ndërtua rreth viteve 1840-1850. Kulla ka qënë trekatëshe, tashmë e këputur në kryq dhe e shndërruar në gjysmë rrënojë, e konsideruar si njëra nga gjiat e gurit më të vjetra të krejt krahinës dhe binjake me "Kullën e Ngujimit" në Theth Krejt afër Kishës, te parapara nga perëndimi gjenden varrezat ku prehën homerikët e vjetër, dëshmia më autentike e burimit shekullor të kësaj bjeshke. Aty të

skalitur në rrasa e kryqe gjenden emrat e pushkatarëve të shquar si Gjelosh Rama, Kolë Salih, Kolë Ademi, Shan Zenuni. Në atë mëzlis rrafshit pushojnë dijetarë të filozofisë popullore dhe ekspert të kanunit si Kukel Ndou, Pal Nika, Mark Elezi, Balec Gjonin, Mark Hasani, Avdi Sylja, Gjon Alia, Isuf Sadiku, Kolë Leka, Grimc Dema etj⁶. Informatorët e devotshëm Martin Gjonin, Kolë Leka, Brahim Gjura, Mark Qerimi kanë zënë strugën duke biseduar me etnografin syzues Rrok Zojzi⁷. Në ato varrë gjendet galeria shumëngjyrëshe e tatave e vjetër, burra fisnike, bujare, trima, si zana, krenar e të bardhë në shpirt. Ata janë kurora me vezulluese, ku shëndrisin traditat tona të vyera, zakoni i odës së burrave, kënga dhe lahuta, mrizi i zanave, kushtrimi kënga maja krahut dhe gjama e burrave. Ato vare të lëna shkret mbajnë brenda dhe ruajnë me fanatizëm rapsodët më autentik të eposit tonë të vjetër të cilëve At B'Palaj "u volli "vargjet e dëlira në buzë duke i mbledhur si bazilika të çmuara në visaret e kombit. Te blini i atyre varre ciceron si zog këngëtar edhe shpirti i rapsodit të çmuar Zef Avdia i cili fizikisht prehet në tjetër vend varresh. Ndër ato varre prehën bujarët e mëdhenj të fisit që priten e përcollën më zemër të bardhë, tërvesë gomilë që i falë miku nderë, respekt, e ngrohtësi në atë masë sa për të gëzoheshin edhe trarët e shtëpisë I lehtë është dheu i atyre varreve të lëna shkretë nga anarkia tranzitore, për bujqit punëmirë që nuk lanë pëllëmbë vend, pa punuar sistemuar e futë nën ujë. Ata çelën tokë re të në rrastë gjallë, ndër-tuan mure prej gurësh ciklopik të lara tre katër bojë të shqyer me thonj nga shkëmbi, për ti mbrojtur nga erozioni dhe zemërimi i përrnjëve të çmendur të vjeshtës. Në ato ara e kopshtie ku gjallojnë bimët kokulura me nga dy kollomoq, ku grosha shkëlqente si inxhi dhe kërtolla (*patatja*) behej e shëndetshme sa një opingë azgani, e kungujt vareshin si shtama ndër stamije. Sot kamë mbirë ferrat dhe drizat. Muret arave janë shkaperderdhe, dhe kullat per bri tyre ngjasojnë si plaga dhëmbzgurdudhuara të molizura në shtratit e rrekkosur të vdekjes. Në ato varre bajnë pushim e pasosur tufëmëdhenjt e moteve të dhive, lopëve e kryesisht të deleve prirë Kolë Leka e Mark Preka nga më të zëshmit e alpeve tona. Delet dhe qingjat e Currajve kur hyjnë në pazarin e Shkodrës apo të Gjakovës, ndonëse përshkonin 4-5 ditë rrugë, "korsinin "bagëtitë e të gjitha trevave të tjera. Gjaja e gjallë ka qënë pasuria ma e madhe, kullosat e mira të bjeshkëve ishte bekim për këtë fshat që ka" notuar" në amel, tyle, djathë e mish. Edhe më i varfëri i këtij katundi, ndoshta ka vuajtur për gjeje e bukë, për veshë, shtrojë e mbulojë, por jo për bulmet. Djathin e Pikut duhet të jesh gastronom ta përshkruash, duhet të kesh duart si stanicat acare bjeshkatara ta ziesh.

Prele Milani,

(vijon në numrin e ardhshëm)

3 Dodë Progni, Zef Deda "Nikaj Merturi vështrim historik" Shtypur në Shypshkronjën "Shtjefni" viti 2003, fq 162-163.

4 Dodë Progni, Zef Deda "Nikaj Merturi vështrim historik" po aty.

6 Inxh Martin Gecaj Gazeta "Nikaj-Merturi" Nr 5. Viti 2005.

7 - Rrok Zojzi "Shala studim etnografik i daktilografuar 1956 . Arkivi i Muzeut Historik Shkodër, fq, 36, 38, 40

ARKIVAT E VATIKANIT

ZBULOHEK RELACIONI I STEFANO GASPARIT I VITIT 1671

- I shkruar në 125 faqe, ky shkrim i tejkalon kufijtë e një relacioni informativ. Është relacioni më i rëndësishëm për historinë e shqipërisë krahas relacionit të marin bicit të 1610-s.

**STUDIUESI MARK PALNIKAJ
NË VATIKAN DHE RELACIONI I
STEFANO GASPARIT**



Ky dokument konsiderohet relacioni më i rëndësishëm për historinë e Shqipërisë për shekullin XVII krahas relacionit të Marin Bicit të vitit 1610.

I shkruar në 125 faqe format i madh, ky shkrim i tejkalon kufijtë e një relacioni informativ dhe ka rëndësinë e një studimi të plotë për zonat që ai i studioi dhe i shkeli me këmbë për dymbëdhjetë muaj pa ndërprerje.

Rëndësia e këtij relacioni qëndron në faktin, se popullsia e Shqipërisë së veriut e përfshirë në territoret e shtatë dioqezave, në shumicën dërmuese i kishte mbijetuar asimilimit fetar dhe nuk e kishte pranuar të bëhej renegat i fesë katolike në pjesën më të madhe të tij.

Këtë qëndresë e kishin bërë në mënyrë të pavarur dhe pa mbështetje nga selia e shenjtë për afër një shekull e gjysmë.

Në masë të madhe ata jetonin si shqiptar, por si të krishterë jetonin vetëm për forcë zakoni dhe jo sepse kisha romane kishte treguar ndonjë përkujdesje të veçante për ta.

Mbas krijimit të organizatës për përhapjen e fesë, në janar 1622 e quajtur ndryshe edhe propoganda fide, u krijuan organizma për të rimëkëmbur besimin e harruar nga një pjesë e popullsisë së vendeve të pushtuara nga perandoria osmane, që bënte pjesë edhe popullsia e Shqipërisë së sotme.

Për përmbushjen e këtij misioni organet më të larta të selisë së shenjtë në Vatikan vendosën të dërgonin një person për të paraqitur një panoramë të saktë të gjendjes së besimtarëve në këto treva.

Personi i ngarkuar me këtë punë duhet të shkonte fshat më fshat dhe të përshkruante në mënyrë të hollësishme realitetin, në të cilin ndodhej popullsia e këtyre vendeve.

Duhet të sillleshin të dhëna për gjendjen dhe numrin e popullsisë, sa ishin konver-

tuar në fenë islame dhe sa e ruanin akoma besimin e mëparshëm, gjendjen e kishave dhe inventarit të brendshëm, shpenzimet e nevojshme për riparimin e tyre, gjendjen e pronave të kishave dhe vlerën aktuale të tyre dhe të dhëna të tjera me karakter social dhe politik.

Relacioni përmban të dhëna të hollësishme për numrin e popullsisë por edhe vendbanimet dhe emërtimin e tyre edhe kur janë katër apo pesë familje.

Ka të dhëna gjeografike ku përfshihen emrat e lumenjve, maleve, krahinave, kufijtë gjeografik të tyre etj.

Ka të dhëna me karakter ekonomik ku tregohet për llojet e bimëve që kultivoheshin, për prioritetet, për gjendjen ekonomike të popullsisë, për monedhat, për shërbimet që ofroheshin si fetare ose edhe shëndetësore deri edhe kirurgjikale.

Nisur nga këto informacione që përfshin ky relacion është konsideruar nga studiuesit e huaj dhe më vonë edhe nga ata shqiptar si relacioni më i rëndësishëm për historinë e Shqipërisë për shekullin XVII. por nëse një relacion i ngjashëm i Zmajeviqit i vitit 1704 është publikuar i plotë dhe pa gabime, relacioni i Gasparit megjithëse njaft me rëndësi, akoma edhe sot e kësaj dite nuk është publikuar vetëm pjesërisht dhe me shumë gabime të cilat vazhdojnë të merren në konsideratë si burime historike të sakta dhe të prodhohen shkrime me gabime të cilat nganjëherë shkojnë deri në tjetërsim të realitetit historik.

Nga të dhënat arkivore merret vesh se dërgimi i Stefano Gasparit në Shqipëri për të raportuar për gjendjen e kishës katolike në këto treva por edhe për gjendjen sociale dhe shoqërore të popullsisë së këtyre trevave, është ndërmarrë nga organet më të larta të shtetit të vatikanit. Ai është përzgjedhur për këtë mision sepse ishte me kombësi shqiptare, njihnte gjuhën dhe zonat në të shtatë dioqezat me popullsi shqipfolëse, kishte mbaruar me sukses kolegjin ilirik të Loretos dhe kolegjin Urbanian në Vatikan dhe mbi të gjitha ishte i njohur edhe për një inteligjencë të mirë në raport me kolegjet e tjerë.

E thënë ndryshe, ai në vitin 1670 kishte mbaruar dy shkolla të larta nga më në zë për atë kohë dhe kjo ishte padyshim një arritje shumë e madhe e tij.

Në fillim ofertën për të kryer një mision të tillë ai nuk e ka pranuar me pretendimin se i rrezikohej jeta nga turqit që kishin pushtuar këto zona dhe se i kishin ofruar një pagesë të pamjaftueshme.

Mbas disa muaj negociatash midis tij dhe eprorëve, është rënë dakord që ai të vizitonte dioqezat me banorë shqipfolës jo si klerik por si një turist, qytetar i thjeshtë kundrejt një shume shumë të madhe monetare për nevoja të shërbimit si ushqim, fjetje, pagesë për kuajt dhe shoqëruesit dhe për ryshfetet që parashikohej se do ti duheshin për pushtetarët e korrumpuar turq nëse ata do ti nxirrnin pengesa.

Shuma e madhe monetare që i është

vënë në dispozicion për të përmbushur misionin e ngarkuar, e vinin atë para përgjegjësisë që detyrën e ngarkuar ta kryente në nivelin më të lartë të mundshëm.

Prandaj ka kaq shumë rëndësi gjetja dhe publikimi korrekt i këtij relacioni sepse në të është përfshirë maksimumi i mundshëm i informacioneve që mund të merreshin në atë kohë nga një person i huaj, nga vende kundërshtarë me pushtuesin osman të vendit tonë.

Në Shqipëri është publikuar i plotë për herë të parë në revistën "Hylli i Dritës" në katërbëdhjetë numra gjatë viteve 1930, 1931 dhe 1932.

Historianët dhe studiuesit e ndryshëm që merren me histori ju kanë referuar këtij relacioni në dhjetëra shkrime të publikuara gjatë këtyre nëntëdhjetë viteve për të ilustruar shkrimet e tyre duke sjellë shumë herë konfuzion dhe pasaktësi të "çertifikuara" me autoritetin e revistës prestigjioze Hylli i Dritës.

I pari që ka reaguuar mbas këtij publikimi ka qenë studiuesi Fulvio Kordinjano, i cili në vëllimin e tretë të librit të tij me titull "l'Albania a traverso l'opera e gli scritti di un grande missionario italiano il p. domenico pasi s. i. 1847-1914", botuar në romë në vitin 1934, i ka kushtuar këtij relacioni një kapitull të tërë, atë të dhjetin, nga faqja 321 deri në faqen 332 duke i bërë një analizë të thellë historikut të këtij relacioni dhe publikimit në revistën "Hylli i Dritës".

Ai ka shkruar se ka kërkuar kopjen origjinale të këtij relacioni në arkivat italiane të kohës dhe nuk e ka gjetur. në vazhdim të punës së tij ai ka lexuar dy kopjet e këtij dokumenti që ishin të ruajtura në dy fonde arkivore në Romë dhe në Napoli.

Mbas studimit të vëmendshëm të të dyja kopjeve dhe të revistës, ai ka arritur në konkluzion se publikimi përmban më shumë se njëqind gabime që vinin nga pamundësia e leximit dhe rishkrimit të realizuar nga paleografët që janë marrë me këtë punë dhe ka publikuar në librin e tij një tabelë me njëqind gabime që ai ka mundur të identifikojë. kjo tabelë është e vendosur në faqet respektive 327 deri 332. në këtë korrigjim të gabimeve të vërejtura ai nuk ka përfshirë paragrafët që mungojnë në kopjen e Napolit.

Tani, mbas tetëdhjetë e shtatë viteve që është publikuar pjesa e fundit e kopjes së këtij relacioni të marrë nga biblioteka kombëtare e Napolit në pallatin mbretëror të këtij qyteti, marrë shkas nga gabimet e shumta që përmban ky publikim, vendosëm të merremi edhe një herë me këtë problem.

Për këtë arsye kemi marrë të plotë kopjen e këtij relacioni që gjendet në Napoli që ruhet si dorëshkrim në 125 faqe, në një dosje me rreth 450 faqe dokumente të ndryshme.

Kemi marrë edhe kopjen që gjendet në arkivin e propogandës fide në Vatikan, edhe ky në dorëshkrim me mbi 125 faqe.

Nga krahasimi i dy kopjeve të përmendura dhe i shkrimit të publikuar në Hyllin e Dritës, lehtësisht dallohet që ka ndryshime të mëdha midis kopjeve në dorëshkrim dhe tekstit të publikuar në revistën në fjalë.

Nga studimi që u kemi bërë këtyre dokumenteve kemi vënë re që kopjet dorëshkrim midis tyre kanë dallime dhe nuk janë kopjuar nga i njëjti person por nga dy kopjues të ndryshëm.

Teksti i publikuar në revistën Hylli i Dritës është një rishkrim i kopjes dorëshkrim të Napolit por i rishkruar me më shumë se njëqind gabime.

Kopja që ruhet në Vatikan ka ndryshime të dukshme sepse ka të shkruara të dhëna që kopja e napolit nuk i përfshin.

Ajo është shumë më e plotë se kopja e Napolit dhe ka disa paragrafë shkrime më shumë, me të dhëna që kopjuesi që ka shkruar kopjen e napolit i ka lënë pa i shkruar për motive që për ne nuk janë të qarta.

Një hamendësim mbi mospërfshirjen e disa paragrafëve në kopjen e Napolit mund të jetë që ai u censuroi për të ruajtur disa të dhëna që për atë kohë mund të konsideroheshin sekrete. por kjo ide e jona mund të konsiderohet vetëm një hamendje e pa bazuar në të dhëna konkrete. arsyeja e mos përfshirjes në kopjen e dokumentit të këtyre paragrafëve mund të jetë krejt tjetër nga ajo që mendojmë ne.

Nisur nga ky fakt, jemi të mendimit, që duhet kërkuar në arkiva të tjera për të bërë të mundur gjetjen e kopjes origjinale të shkruar nga autori dhe të bëhet rishkrimi dhe publikimi nisur nga kopja origjinale. nëse kjo nuk arrihet, atëherë duhet rishkruar korrektësisht kopja që gjendet në arkivin e propogandës fide dhe duhet përkthyer me kujdesin më të madh duke u konsultuar persona njohës të mirë të terrenit në secilën dioqezë.

Jemi të mendimit që kopja origjinale mund të ndodhet në arkivin sekret ose në fondin e dorëshkrimeve të bibliotekës apostolike në vatikan.

Nisur nga ky fakt, e ndërmorëm shkrimin e këtyre radhëve për këto qëllime:

së pari me qëllim që institucionet shtetërore zyrtare të japin fondet e nevojshme për të bërë një studim dhe publikim zyrtar serioz të këtij dokumenti. nëse jepen fondet e nevojshme, jemi të gatshëm për të bërë studimin e nevojshëm dhe publikimin anastatik me ngjyra të të dyja kopjeve të këtij dokumenti me rëndësi.

së dyti, nëse institucionet shtetërore zyrtare nuk merren me këtë problem, shoqëria civile në bashkëpunim me institucione arsimore, të mundohen që të gjejnë një kandidat për gradë shkencore dhe ti ngarkohet kryerja e plotë e studimit të këtij dokumenti në këmbim të marrjes së gradës shkencore.

së treti, ata që i referohen këtij dokumenti ti marrin në konsideratë të dhënat e këtij shkrimi për të mos rënë pre e gabimeve të kopjuesve dhe të publikuesve të tij.

Rëndësia e këtij dokumenti është shumë e madhe prandaj u bëj thirrje Institucioneve Shtetërore që ti japin rëndësinë që ka studimit të këtij dokumenti dhe të publikohet sa më i plotë.

“QEVERIA NUK I ZGJIDH PROBLEMET TONA. QEVERIA ËSHTE PROBLEMI YNE...!”

“Aktori komik” që po shkund sistemin politik të Ukrainës

Fjalimi i marrjes së detyrës nga presidenti ukrainas, Volodimir Zelenski

Të dashur ukrainas! Pas fitores sime në zgjedhje, djali im gjashtëvjeçar tha: “Babi, ata thonë në TV, se Zelenski është Presidenti ... Pra, kjo do të thotë se ... Unë jam ... Presidenti gjithashtu?!» Në atë kohë, kjo tingëlloi qesharake, por më vonë kuptova se ishte e vërtetë. Sepse secili prej nesh është Presidenti. Jo vetëm 73 % që votuan për mua, por të gjithë 100 % e ukrainasve. Kjo nuk është vetëm imja, kjo është fitorja jonë e përbashkët. Dhe ky është shansi ynë i përbashkët që ne jemi së bashku përgjegjës. Nuk jam vetëm unë që sapo kam bërë betimin. Secili prej nesh sapo ka vënë dorën e tij mbi Kushtetutën dhe është betuar për të qenë besnik ndaj Ukrainës. Tani, imagjini titujt: «Presidenti nuk paguan taksat», «Presidenti i dehur kaloi me dritë të kuqe» ose «Presidenti po vjedh në heshtje, sepse gjithkush kështu vepron». A do të pohoni se është e turpshme? Kjo është çfarë mendoj kur them që secili prej nesh është President. Që tani e tutje, secili prej nesh është përgjegjës për vendin që ua lëmë fëmijëve tanë.

Secili prej nesh, në vend të tij, mund të bëjë gjithçka për mirëqenien e Ukrainës. Vendi ynë evropian fillon me secilën prej nesh. Ne kemi zgjedhur një rrugë për në Evropë, por Evropa nuk është diku atje tej. Evropa është këtu (në kokën tonë – shën. P. L.) Dhe pasi ajo të shfaqet këtu (në zemrën tonë – shën. P.L.) ajo do të jetë kudo, në të gjithë Ukrainën. Kjo është ëndrra jonë e përbashkët. Por ne gjithashtu kemi një dhimbje të përbashkët. Secili prej nesh ka vdekur në Donbas. Çdo ditë humbim secilin prej nesh. Dhe secili prej nesh është një refugjat – ai që ka humbur shtëpinë e tij dhe ai që ka hapur derën e shtëpisë së tij, duke ndarë dhimbjen. Dhe secili prej nesh është një emigrant – ai që nuk mund të gjejë veten në shtëpi, por ka gjetur të ardhura në një vend të huaj dhe ai që lufton me varfërinë, i detyruar të humbasë dinjitetin e vet. Por ne do të kapërcejmë gjithë këtë! Sepse secili prej nesh është një ukrainas. Ne jemi të gjithë ukrainas: Nuk ka ukrainas më të madh ose më të vogël, ose ukrainas të saktë ose të gabuar. Nga Uzhgorod në Luhansk, nga Çernigiv në Simferopol, në Lviv, Harkiv, Donjetsk, Dnipro dhe Odesa – ne jemi ukrainas. Dhe ne duhet të jemi një. Në fund të fundit, vetëm atëherë ne jemi të fortë. Sot i bëj thirrje të gjithë ukrainasve në botë. Ka 65 miliona prej nesh. Po, mos u habitni: Ka 65 milionë prej nesh – ata të lindur në tokën e Ukrainës. Ukrainas në Evropë dhe Azi, në Amerikën Veriore dhe Jugore, Australi dhe Afrikë – Unë iu bëj thirrje të gjithë ukrainasve në planet! Me të vërtetë kemi nevojë për ju. Për të gjithë ata që janë të gatshëm të ndërtojnë një Ukrainë të re, të fortë dhe të suksesshme, me kënaqësi do t’iu japim shtetësinë ukrainase. Duhet të vini në Ukrainë, jo si vizitorë, por të ktheheni në shtëpi. Ne po

presim për ju. Nuk ka nevojë të sillni dhuratat nga jashtë, por ju lutemi, sillni njohuritë tuaja, përvojën dhe vlerat tuaja! Kjo do të na ndihmojë të fillojmë një epokë të re. Skeptikët do të thonë se është e pamundur, një fantazi. Paçka nëse është, në fakt, ideja jonë kombëtare – le të bashkohemi dhe të bëjmë të pamundurën kundër të gjitha gjasave. Mos harroni ekipin e futbollit të Islandës në Kampionatin Evropian – kur një dentist, një drejtor, një pilot, një student dhe një pastrues mbrojtën vendin e tyre? Askush nuk besonte se mund ta bënte, por e bëri! Dhe kjo duhet të jetë pikërisht rruga jonë. Ne duhet të bëhemi islandezë në futboll, izraelitë – në mbrojtje të vendit të tyre, japonezë – në teknologji dhe zviceranë – në aftësinë për të jetuar me njëri-tjetrin në harmoni, pavarësisht nga të gjitha dallimet. Megjithatë, detyra jonë e parë është armëpushimi në Donbas. Më kanë pyetur shpesh: Çfarë çmimi jeni i gatshëm të paguani për armëpushimin? Është një pyetje e çuditshme. Çfarë çmimi jeni i gatshëm për të paguar për jetën e të dashurit tuaj? Unë mund t’ju siguroj se jam i gatshëm të paguaj çdo çmim për të ndaluar vdekjen e heronjve tanë. Patjetër që nuk kam frikë të marr vendime të vështira dhe jam gati të humbas famën time, vlerësimet ndaj meje dhe, nëse është e nevojshme – pa asnjë hezitim, ofiqin tim për të sjellë paqe, për sa kohë që ne nuk heqim dorë nga drejta mbi territoret tona. Historia është e padrejtë. Ne nuk jemi ata që kemi filluar këtë luftë. Por ne jemi ata që duhet ta përfundojmë atë. Dhe ne jemi gati për dialog. Unë besoj se hapi i parë i përsosur në këtë dialog do të jetë kthimi i të gjithë të burgosurve ukrainas.

Sfida jonë e ardhshme është kthimi i territoreve të humbura. Me gjithë ndershmërinë, ky formulim nuk duket krejtësisht i saktë për mua, sepse është e pamundur të kthejmë atë që ka qenë gjithmonë e jona. Si Krimea dhe Donbasi ka qenë toka jonë, e Ukrainës, por edhe toka ku kemi humbur gjënë më të rëndësishme – njerëzit. Sot ne duhet të kthejmë mendjen e tyre – kjo është ajo që kemi humbur. Gjatë viteve, autoritetet nuk kanë bërë asgjë për t’i bërë ata të ndihen ukrainas dhe të kuptojnë se ata nuk janë të huaj, por ata janë populli ynë, ata janë ukrainas. Dhe, edhe nëse u jepet 10 pasaporta të ndryshme, nuk do të ndryshojë asgjë. Për të qenë ukrainas nuk është një vizë në pasaportë – ukrainasi ndjen këtu (në zemër – Shën. P.L.) Unë e di këtë me siguri. Unë e di se nga ushtarët që tani po mbrojnë Ukrainën, heronjtë tanë, disa prej të cilëve janë folës ukrainas, ndërsa të tjerë – folës rusë. Atje, në vijën e frontit, nuk ka grindje dhe mosmarrëveshje, ka vetëm guxim dhe nder. Pra, unë dua të apeloj tek mbrojtësit tanë tani: Nuk mund të ketë ushtri të fortë në një vend ku autoritetet nuk i respektojnë njerëzit që çdo ditë sakrifikojnë jetën e tyre për vendin. Unë do të bëj gjithçka që mundem për t’ju bërë të ndiheni të respektuar. Kjo do të thotë të mirë, dhe më e rëndësishmja, të siguroheni që pagat,

kushtet e jetesës, profesionin e lënë pas misionëve luftarake dhe festat tuaja dhe të familjeve tuaja. Ne nuk duhet të flasim vetëm për standardet e NATO-s – ne duhet të krijojmë këto standarde. Sigurisht, përveç luftës, ka shumë probleme

Dhe për këtë, ne kemi nevojë për njerëz në pushtet që t’i shërbejnë popullit. Kjo është arsyeja, pse unë vërtet nuk dua fotot e mia në zyrat tuaja, sepse Presidenti nuk është një ikonë, një idhull apo një portret. Vërinë fotot e fëmijëve tuaj në vend



të tjera që shqetësojnë ukrainasit. Midis tyre janë tarifët e shërbimeve shokuese, pagat dhe pensionet poshtëruese, çmimet e dhimbshme dhe papunësia. Ekziston edhe mungesa e kujdesit shëndetësor që shihet si e përmirësuar më së shumti nga ata që kurrë nuk kanë qenë në një spital shtetëror me fëmijën e tyre. Dhe pastaj, ka edhe rrugët mitike të Ukrainës që po ndërtohen dhe riparohen vetëm në imagjinatën e pabesueshme të dikujt.

Më lejoni të citoj një aktor amerikan, i cili u bë një president i madh amerikan: “Qeveria nuk i zgjidh problemet tona. Qeveria është problemi ynë. »

Unë nuk e kuptoj qeverinë tonë që vetëm ngre supet dhe thotë: «Nuk ka asgjë që mund të bëjmë.» Aspak e vërtetë. Ti mundesh. Ju mund të merrni një fletë letre dhe një stilolaps dhe të përcaktoni lirisht kush i meriton vendet (mandatin Shën. P.L.), ata që mendojnë për gjeneratat e ardhshme dhe jo për zgjedhjet e ardhshme! Bëni atë dhe njerëzit do ju vlerësojnë. Duartrokitja juaj është shumë e lehtë ... Unë mendoj se jo të gjithë i pëlqejnë ato që po them? Shumë keq, pasi nuk jam unë, por populli ukrainas që po e thotë këtë. Zgjedhja ime dëshmon se qytetarët tanë janë të lodhur nga sistemi politik pompoz i eksperimentuar që gjatë 28 viteve ka krijuar një vend të mundësive – mundësive për ryshfet, vjedhje dhe përvetësimin e burimeve. Ne do të ndërtojmë vendin e mundësive të tjera – atë ku të gjithë të jenë të barabartë para ligjit dhe ku të gjitha rregullat janë të ndershme dhe transparente, të njëjta për të gjithë.

të tij dhe shikojini ato çdo herë që merrni vendime. Unë mund të vazhdoj, por ukrainasit dëshirojnë veprime, jo fjalë. Pra, të dashur deputetë! Ju e caktuat inaugurimin tim të hënën, një ditë pune, e cila ka një përfitim – kjo do të thotë që jeni gati për të punuar.

Prandaj, ju kërkoj që të miratoni:

Ligjin për heqjen e imunitetit parlamentar.

Ligjin që përcakton përgjegjësinë penale për pasurimin ilegal.

Kodin Zgjedhor të shumëpritur dhe listat e hapura.

Gjithashtu, ju lutemi të shkarkoni:

Shefin e Shërbimit të Sigurisë të Ukrainës.

Prokurorin e Përgjithshëm të Ukrainës. Ministrin e Mbrojtjes të Ukrainës.

Kjo sigurisht që nuk është e gjitha që mund të bëni, por tani për tani, do të mjaftonte. Ju do të keni dy muaj kohë për ta bërë këtë. Bëjeni. Dhe merrni të gjitha medaljet për këtë – një veprim jo i keq para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Unë po shpërndaj sesionin e tetë Parlamentar!

Lavdi Ukrainës!

Dhe më në fund: Komb i dashur!

Gjatë gjithë jetës sime unë u përpoqa të bëja gjithçka që munda, në mënyrë që ukrainasit të qeshin. Ky ishte misioni im. Tani unë do të bëj gjithçka që mundem në mënyrë që ukrainasit të paktën të mos qajnë më.

Përktheu, Petro Luarasi

Nga Gazeta Telegraf 21 Maj, 2019

KONCEPTE MBI HAZARDIN

HAZARDI (fati, probabiliteti, rastësia, rreziku)

Hazardi (rastësia) shpesh shpreh mungesën shkak-pasojë të një ngjarje. Flasin rreth rastësisë (fatit-shansit): probabiliteti që një ngjarje mund të ndodh e të ketë një përfundim të pafavorshëm (Last 1995).

Kur gjendemi në një situatë të pa parashikueshme (të takuar rastësisht), ku përshkruajmë një gjendje të rëndë të pa parashikuar në një kohë unike do të flitet për fatalitet (pra kjo do të ndodh një ditë); kur nuk dimë se çfarë do ndodh “është hazardi – shansi- që vendos”; kur nuk duam të hyjmë në detaje të shaksisë;

Dy pasiguritë kundërshtohen (nënkupohen me termin :

Atë mbi shkakun (në se ka shkaqe) dhe atë mbi rrjedhojat (pasojat) /në se ka pasojat/. Një nga momentet më të njohur të hazardit (që nga Antikiteti) është në se qeveriset (drejtohet) nga ligje statistikore të mirë përcaktuara, është ai që luan rol dhe rregullon (saktëson) mundësitë përfituese – shpresuese nga organizimi i lojërave të fatit. Nuk është një evoluim në kuptimin e fatit (shansit). Shumë ngjarje që ishin konsideruar si hazard (të rastësisë) para shumë shekujsh nuk janë më të tilla si pasojë e zbulimeve socio-kulturore, shkencore ose psikologjike. Nga perspektiva determinuese (përcaktuese), nocioni i hazardit (shansit) me shqetësim për të kapur në mënyrë të plotë disa fenomene në kompleksin e tyre natyral dhe pra me parashikim të pa gabueshëm. Kjo pamundësi e parashikimit dhe kontrollit përben një rrezik potent.

Nga ana etimologjike origjina e fjalës “hazard” i atribuohet arabishtes “al-zahr” që do të thotë “prag” e që ka marr domethënë-e shans (fat) nga që simbolizohet deri në shekullin e XII në lojërat e fatit (kumarit), po ashtu për metafore në gjithë fushat relevante të “shkencës së fatit” (Averoës). Megjithatë CNRTL sinjalizon term al-zahr ne sensin “prag”; për lojërat është relativisht modern e presupozon prejardhje nga “yassara” (të luash me zare, kokë-pilë), ekzistencë e cila atestohet me araben klasike. Fjalës i ngarkohet domethënie e re pikërisht ajo e rrezikut, që tashmë perceptohet në fjalën franceze “haserdeux” (të rrezikshme); ky sens i ri përbën bërthamën semantike në fjalën anglisht “hazard”.

Hazardi (rastësia) në shkencë

Po të mbahet parasysh pikëpamja deterministe e shkencave çdo fenomen ka domosdoshmëri një shkak. Pra nuk mund të cilësohen të rrezikshme sistemet dinamike me nivel kompleksiteti të tillë që mendja njerëzore nuk mund të përcaktojë fatin,; p.sh : lëvizjet e zareve ose daljen e goglave të Lotarive, apo vëndalimin e roletës. Mund të thuhet se hasard-i aplikohet në sistemet e bindjes, në teorinë e kaosit.

Hasardi në fusha të ndryshme shkencore

Dhe shfaqja e genies njerëzore është e shkaktuar nga hasard-i: fekondimi në se kemi vajzë a djalë..... (Shih në vijim)

Sipas Nicolas Gauvrit zona që në matematikë mundemi të mësojmë diçka

për hasard-in (rastësinë) janë :

Probabiliteti (mundësia) që përfshin teorinë ergodike (pëlqimit)

Sistemet dinamike (përfshin teorinë e kaosit)

Teoria grafike

Semantika e Kripke për logjikën

Teoria algoritmike e informimit, në informatikën teorike (shkenca kompjuterike teorike).

Shkencat ekzakte janë ato që kërkojnë të zvogëlojnë efektin hasardit (rastësisë). Në teorinë e probabilitetit dhe në statistike flitet për variabël d.m.th çrregullim probabiliteti.

Në informatikë termi hasard (rastësi, shans) mund të duket mjaft i pa përshatshëm, por kur flasim për fat (shans); duam të flasim sidomos për gjenerimin e numrave pseudo të rastësishëm:

- logjika na supozon që të jetë shumë larg problemit të injektimit për të mos u dalluar nga një prag vërtetë i rastësishëm.

Në matematikë shifrat (decimal-Pi) nuk kanë asgjë të rastësishme për shpërndarjen e numrave ose të grupeve të N-shifrave konsektive (të njëpasnjëshme) të decilmave, megjithëse kanë karakteristikat e një fenomeni të rastësishëm.

Artikulli i detajuar (kryesor) variabël i rastësishëm;

Në teorinë e informacionit algoritmik (rastësisë) rregullojnë shumë fenomene natyrore: p;sh:

Në fizikë : fenomenet janë paraqitur si të pa sigurt. Është rasti p.sh. në mekanikën kuantike ose në teorinë kinetike të gazeve.

Cili është shembulli që bie më shumë në sy në mjekësi??

FEKONDIMI (Ngjizja): - nga miliona spermatozoid, vetëm një arrin deri tek qeliza veze (ovo-celula) dhe e fekondon. Përse njeriu më herët se të tjerët? Çështje hasardi (rastësie, shansi), fakt ky që do gjeje përkthim, shpjegim perfekt; 9 (nënte) muaj me vonë, me lindjen e një vogëlusheje që do të ketë sy të çelur boje qielli dhe flokë biond me një vëlla me sy të zi dhe flokë gështenjë (të errët); Përse këto kombinime dhe jo të tjera ? Riprodhimi seksual është para se gjithash, çështje probabiliteti, shansi. A nuk është bindëse? Marrim atëherë çështjen që ne zanafille; Po të shohim në intimitet, shumica e qelizave tona kanë 46 kromozome (23 të ardhur nga babai dhe 23 të ardhur nga nena të vendosura në 23 çifte (njeri prej këtyre çifteve bën përjashtim ai seksual (gametat). Në këto kromozome gjenden genet tona. Gametat janë të organizuara tek femra ovulë dhe tek meshkujt ne spermatozoidet, të cilët kanë një numër aploid (të përgjysmuar) kromozomesh, pra secili 23 kromozome. Përse? Nga që në kundërshtim me të gjitha qelizat e tjera të trupit tonë të cilat replikohen (shumëzohen) në mënyrë “identike”, qelizat seksuale në kohen e gjenezës se tyre nuk marrin kapital tjetër veçse një kopje trashëgimie gjenetike dhe kjo kopje është unike (e vetme) nga që ndryshon imtësisht nga të tjerat. Si? Në sajë të procesit të quajtur të

“mejozës” (përgjysmimit), ku shihet një qelizë meme të japi katër qeliza bija, nga ku ndodhin dy ndarje qelizore të njëpasnjëshme, kështu veza ka 23 kromozome, 22 kromozome somatike dhe 1 kromozom seksual, ku seksuali është gjithnjë i njëjtë “X”, ndërsa spermatozoidet kanë 22 kromozome somatike dhe 50% e tyre kanë kromozom seksual “X” dhe 50% të tjerët kanë kromozom seksual të ndryshëm “Y”. Pra në fekondim kemi një bashkim të ovocelulës (22X + X) me spermatozoid (22X + X) që jep sex femër ose (22X + Y) që jep sex mashkull, pra në fuzionin veze spermatozoid plotësohet numri 46 i kromozomeve si : 23 nga babai dhe 23 nga nena (22 çiftet X + 1 çift seksual XX) ku kemi sex femër ose 22 çiftet “X” + çift seksual XY ku kemi sex mashkull. Pra sexi vendoset nga mashkulli (burri). Pra ky moment i biologjisë riprodhuese kulmon gjate fekondimit me përzierjen e qelizës veze me spermatozoidin dhe krijohet një qelizë habitshme, me probabilitet që të ngjasojë me prindërit e vet.

Në biologji : ligjet e trashëgimisë ndjekin ligjet e hasardi-it (në se do të kemi në djalë apo një vajzë). Evolucioni i botës së gjallë është pjesërisht i hasardit (rastësisë) ne flasim për të parashikueshmen kontingjentet e evolucionit (tek “le hasard et necécite”) hazardi dhe domosdoshmëria.

Në mjekësi: disa sëmundje shumë faktorësh si kanceri etj, nuk janë të parashikueshme. Shkencat humane (shoqërore) dhe shoqërore e sociale përmbajnë një pjesë të fortë rastësie: (hasardi), Ja cilët janë shembujt :

Në sociologji: sondazhet bëhen mbi njerëz të tërhequr rastësisht

Në psikologji – teoria e probabilitetit subjektiv studion mënyrën si e ndiejmë : perceptojmë hasard-in (shansin, rastësinë)

Si ta mposhtim (kapërcejmë) hasardin - Kuptoni fenomenet për ti parashikuar

Për një metodë shkencore dhe eksperimentale

Për një metodë empirike (nga përvoja, eksperiencia)

Sa më tepër marrim në konsideratë një numër të madh ngjarjesh (vlerësojmë) aq më tepër ulet efekti i hasard-it (rastësisë). P.sh : në se tërhiqet 1000 herë pila (goglat) ose të hedhësh pilë-kokë ose zarin konfigurimi më i mundshëm është që të kemi shumë herë rezultatin “pilë” krahasuar me “kokë”, probabiliteti i saj është 0,0080 preçizim i domosdoshëm.

Për më tepër realizohen dështime më tepër se sa suksese, arrihet të merret një rezultat pilë i monedhës (në lojën pilë-kokë) (për 100 lëshime probabiliteti dalues në duelin pilë-kokë ose në hedhjen e zarit numri i premtuar ka diferencë me të tjerët, pra diferenca midis dy vlerave të paktën për 20 është 0,49 për 10.000 hedhje, probabiliteti (pilë-kokë) dallues të paktën për 200 është 0,96. Në terma matematike këto rezultate janë dhënë me ligjin e numrave të mëdha.

Përpjekje përkufizuese : -

Është interesant për të shënuar

përkufizimin e hasard-it që jep Aristoteli në “Leçons de physique” (Mësimet e fizikës): “Ka një grumbull (tok) gjerash që prodhohen dhe janë si efekt i rastësisë dhe i spontanitetit, “por pohohet se hasard-i e asgjë që vjen nga rastësia nuk mund të jetë shkak ; as gjëra të domosdoshme dhe të përhershme ose gjëra që ndodhin në shumicën e rasteve “ –Aristoteli-

Me një fjalë shansi nuk mund të vijë veçse nga rastësia;

Është interesant të vihet ky përkufizim paralel me atë që jep Counnot në shekullin e XIX, ku përkufizimi i hasard-it në një propozim u bë i famshëm (dëgjuar) si takimi i dy serive shkakësore të pavarura. Ngjarjet janë marr si plotësisht të angazhuara për çështjen e tyre dhe me efekt të pa parashikuar. Ngjarjet janë parashikuar si krejt të përcaktuara për sa i takon shkakut e pasojës ku është i parashikuar (takimi) i tyre, ndërhyrja e një shkakut të ri të pavarur në shpalljen e një procesi të lindur nga rastësia p.sh: në se shiu ka dëmtuar çatinë (pullazin) e një shtëpie dhe për rrjedhojë çon në një tjetër dëm shkak e pasojë, shkëputjen e një tjegulle, gjendemi në një seri shkakësore; në se behet kohë e mirë pas shiut, kohë me diell gjendemi në një tjetër seri (histori) shkakësore.

Në se më bie një tjegull në kokë është hasard-i (fati), rastësia, që ka sjell dy procese që konkordojnë (ç’palosen) në kohë dhe në hapësirë. Ky përkufizim i hasard-it (shansit) lidhet me teorinë e kaosit që merret plotësisht me sistemet deterministe, por megjithatë kanë sjellje kaotik-e që mund të interpretohen si shans.

Masa e Hasarit (shansit)

Shkencërisht; fitimi i probabilitetit të trajtimit të një numri të madh lejon të studiohet shfaqja dhe zhvillimi i formave të shansit.

Teoria e probabilitetit e Blaise Pascal ka kontribuar gjerësisht për themelimin (themelimi instrumental).

Rivënia si shkak e hapësirës matematikë për kriter universal të dobishëm nga Emil Borel në 1928.

Methematizimi i nocionit të hasard-it nga Andrey Kolmogorov me nocionin e kompleksitetit të Kolmogorov;

Mathematizimi i kontigjencës nga Andrey Kolmogorov, në vitin 1931 me ekuacionin “forëard” (para) dhe “backëard” (prapa).

Përdorimi i probabilitetit në çështjet e strategjisë ushtarake e ekonomike për teorinë e lojës së Johnvan Neuman dhe Oskar Margenstern në 1944 (strategji mixte).

Mathematizimi i hasard-it (rastësisë) në observimin e fenomeneve kuantike (relacioni i pasigurisë Heisenberg).

Gjendet një jehonë e filozofisë presokratiane sipas së cilës “çdo gjë” që ekziston është frutë i hasardit (rastësisë) dhe i domosdoshmërisë”.

Rastësia e lëvizjes dhe e heqjes (takimit) të atomeve tek Demokriti do të rishihet në mekanikën kuantike; sipas të cilës hasardi (fati) nuk mund të përcaktohet veç aty ku ka një observus; funksionet e valës janë në fakt të përcaktuara në mënyrë të përkryer, veçse lidhja e tyre është rastësore.

Është e rëndësishme të mos konfrontohet (ngatërrohet) kaosi dhe

hasardi (rastësia).

Sjellja e parregullt (instabiliteti) e sistemeve rezulton një lëmsh (ngatërrim) i serisë shkakësore që krijon konflikt veprimi, që ngjason i pavarur sepse për ti analizuar ka shumë komplekse. Hazard-i është shpesh një mungesë informacioni, në se ka mundësi të ekzistojë ose jo. Megjithatë sistemet kaotike janë përdorur shpesh në gjeneratorët e hasard-it.

Kompleksiteti nuk ndërhyr me si i tillë - : mund të ndërtohet një numër modele shumë të shpeshta për të bind për një proces të parashikuar ose prurja e të cilit duket e çuditshme (habitshme). Një funksion emergjence shfaqet shpesh në sistemet komplekse të observuara dhe të siguruara të nocionit të vetorganizimit. Hazard-i (shansi) shpesh mund të transkriptohet në ligjet e probabilitetit. Probabiliteti dhe praktika statistikore lejojnë një observim më fin (imtë) të botës dhe pra parashikime më të përpikta në të ardhmen.

Por një dallim themelor duhet të bëhet në lidhje me format e ndryshme të fatit, siç tregohet nga Mandelbrot në "Hasard, fractales et finance" ekzistojnë dy lloj rastësish – rast "benign" dhe rast i "egër". Për

hasard-in "benign" (të mirë), kur numri i observimeve rritet, luhatjet janë gjithnjë e më pak të rëndësishme (ky është ligji i numrave të mëdhenj). Teorema qendrore kufi : e tashmja është e pavarur nga e kaluara mjaft e largët.

Hasard-i i "egër" është shumë i ndryshëm nga që korrespondon me ligjin ose një observim i thjeshtë mund të ndryshojë mesataren e ardhur nga mijëra observime; llogariten ngjarje "kantastrofike" ose "patologjike".

Hasard-i i "egër" është shumë i lig sepse nuk lejon të arsyetohet për terma mesatar. Në se ju merrni 10 (dhjetë) qytete të Francës rastësisht dhe ju shkoni në Paris, Lion, Marseille, juve do t'u bjer madhësia mesatare e kampionit (mostrës) tuaj. Në se ju merrni Parisin dhe 9 (nënte) fshatra, mesatarja nuk nxjerr asnjë konkluzion mbi popullsinë e qyteteve të tërhequr rastësisht (B. Mandellbrot). Kjo diferencë tregon sesi inferenca (Konkluzioni) statistikore do të thotë të behet zbritja e një kampioni të dhënë informativ mbi procesin, që gjeneron këtë kampion (mostër) është një ndërhyrje shumë komplekse në statistikën konkluzive.

Dobia e përdorimit të hasard-it

Dobia e hasard-it për të lehtësuar analizat, por jo vetëm kjo : - shumë fenomene reale të parashikuara ka nevojë të dimë të përdorim shansin (hasard-in); në se done kopje te tyre, ky është pikërisht rasti i simulimeve.

Në teoritë e lojërave llogaritet shansi. Kjo lojë ekonomike e John Yan Neuman dhe Oscar Margensern tregon strategjitë optimale për t'u përballur me një kundërshtar, nganjëherë janë strategjitë mixte - : është e vështirë të parashikohen lëvizjet tuaja në se keni xhiruar në mënyrë, të rastësishme, por akoma duhet të tërhiqni në mënyrë optimale dhe aq më pak të favorshme do të jenë për kundërshtarin tuaj.

Për kuptimin dhe kontrollin e hasard-it nevojitet një modelim i mirë i shansit.;

Metodat e llogaritjes numerike bazuar në hasard-in (rastësi) quhen metodat Montekarlo.

Disa përcaktime të hasard-it

"Ajo që quajmë hasard, ndoshta është logjika e perëndisë" - Georges Bernanos

Shansi (hasard-i) ky është ligji që nuk e dimë: - Emil Borel

Metoda MONTEKARLO – Kjo metodë përdor numra të rastësishëm për të stimuluar situata të llogaris integrale

ose zgjidhje ekuacionesh diferenciale pjesore. Kjo metodë përdoret sidomos në fizikë, ku përllogariten algoritme që aplikohen pastaj për analizën e rezultateve eksperimentale. P.sh :

Fenomene të paparashikueshme : me zare; ruletë.

Operacione matematikore – brenda algo-bingo-ritmit të pa parashikuar

Proceset fizike – rrezatimet- gjysmë reflektues;

Ajo që ne quajmë hasard (fat) është dhe nuk mund të injorohet si shkak i një efekti të njohur – Valteri

Disa përkufizime të hasardit nga personalitet të ndryshme botërore :

"Hasard-i është ndoshta personifikimi i zotit, kur atë nuk e nënshkruajmë" Thefile GAUTIER

"Hasard-i (shansi) mund të jetë pseudonim i zotit që udhëton "inconito". Albert Anstein

"Hasardi – (rastësia) si zot i panjohur luan rol të madh në jetë " Hektor Berlioz

Përgatiti: Dr. Med. Ndue NIKAJ

VORRI I NUSES

Vorri i nuses gjendet në fshatin Mullet të Tiranës pranë rrënojave të kushës së Magjarës. Ky monument mbart një legjendë për nusen e re që vdiq ditën e dasmës.




Foto - Varri i nuses

Një nuse anonime e vdekur në rrugë, në prani të krushqve ka një histori sa të dhimbshme, aq edhe trishtuese. Enigma e saj ka humbur tashmë në kujtesën e mbi katër shekujve të shkuar për të na arritur sot vetëm përmes një monumenti të quajtur "Vorri i Nuses" pozicionuar në një livadh në anën e majtë të rrugës Mullet – Gurrë e Tiranës në afërsi të Kishës së Magjarës..

Kjo ngjarje e ndodhur në këtë zonë, sot interpretohet në tri variante të ndryshme prej popullit përreth.

"Na ishte njëherë një vajzë 16 vjeçe, e cila thuhej se kishte ra në sevda (dashuri) me një djalë diku afër shtëpisë së saj. Prindit e kuptuan këtë gjë dhe vendosen ta martonin sa më shpejt. Prej kah ishte dhe ku shkonte, askush nuk e di gjë – më

ka pas thanë në vitet 70', plaku Myrteza Hasmema prej Petrele. Kështu erdh dita dhe krushqit u nisen bashkë me nusen për të shtëpia e burrit. Me gjithë kundërshtimin e saj, zakoni e donte që ajo vajzë e re të shkonte atje ku ia kishin caktuar fatin prindit e saj. E hipur mbi shpinën e kalit e nën duvak, vajzës së re nuk iu terën sytë prej lotëve gjithë rrugës. Diku në njëfarë vendi, pikërisht afër katundit të Mulletit, nusja u kërkoi leje krushqve për nevoja personale, por ishte gjithnjë nën vëzhgimin e krushkës shoqëruese. Prej gjoksit, ajo nxjerr një



thikë të fshehur në trup dhe pret damarët e duarve. U dha alarmi ndër krushq dhe vendas, por qe e pamundur t'i shpëtohej jeta vajzës. Në grahamat e vdekjes, nusja vajze apo vajza nuse u la amanetin e fundit: "Mos më varrosni të shtëpia e burrit,

e sipër nusja u vra aksidentalisht. Unë gjithsesi mendoj se më i pranueshëm mbetet varianti i parë, mbasi nusja do të varrosej o te shtëpia e nënës o te e burrit dhe nuk mund të lihej në një vend vakant. Edhe varianti i fundit përm-



por as te nëna jo!"

Amanetin s'e tret as dheu! – thonë ndër shqiptarë – dhe krushqit vërtet u ndalën, ia bane vorrin dhe e varrosën pikërisht aty ku ajo kish dhanë shpirt!

Më vonë fshatarët vendas i bënë këtë monument që shpesh ata e quajnë edhe "Tyrbe".

Ka një variant të dytë ku tregohet sikur nusja u sëmur rrugës dhe vdiq papritmas në shalë të kalit? Por është edhe varianti i tretë, sipas mikut tim, Osman Bunoca prej Mulleti, i cili më ka rrëfye se krushqve iu zu pritë dhe në betejë

ban elemente të ngjarjes së parë, mbasi pusinë mundet t'ua kenë zane të afërmit e ashikut të vajzës, ku djalit iu bë pabesia e martesës së vajzës dhe në shkëmbim zjarresh mund te jetë vra vajza.

Gjithsesi ky "Vorr i Nuses" asht një mrekulli që dëshmon edhe njëherë se dashnia e sfidon vdekjen, ku edhe vdekja nuk e shuan dashninë. Ka rreth 40 vjet që dëshiroja t'i bëja një foto këtij objekti dhe veç tani mu dha rasti. Pushofsh në paqe moj vajzë anonime që nuk mbërrite të bashesh nuse as në shtëpi të burrit, as të ashikut, po diku midis një fushe e pranë një kiske dhe mbas shekujsh dikujt iu kujtua me shkruajtë për ty!!

Ndoc Selimi

PIKTORI I VOGËL

Emanuel Lungaja

Emanuel Lungaja, është nxënësi i klases së VIII, në shkollën 9 vjeçare "Dede Gjon Luli", në Hot të Ri.

Emanueli, është me origjinë nga lagja Kuje e fshatit Plan, të krahines së Pultit dhe banon në Hot të Ri. Ndryshe nga vëllezërit e motrat e tij, Emanueli ka pasion të veçantë pikturën. Është një nxënësi i mirë dhe i sjellshëm. Në Keshilli i Mesusve është shumë i përfshire për ta mbështetur këtë talent të ri, i cili sot ka nevojë për perkrahje e për nxitjen e punës krijuese të tij. Një ndihmesë ka në mbështetjen që i jep Shoqata "World-vision", e

cila punon në shkollën me projekte të ndryshme, na ka mbështetur duke furnizuar shkollën me baze materiale për pikturën e vogël.

Emanueli ka realizuar portrete të figurave të ndryshme, që ne si shkollë i dhene dhurate, në shenjë mirënjohje si psh: për Ndue Sanaj, kryetarin e shoqatës atdhetare "Dukagjini"; për Ukshin Jashari, kryetari i shoqatës së vëllazërimit Kosovë-Malesi e Madhe "Mrtin Dreshaj", për Kastriot Faci, kryetari i organizatës "TheDoor" e të tjere.

Gjovalin Kodra



E DJESHMJA, E SOTSHMJA, E NESËRMJA!

E djeshmja iku, e sotmja po na lodh;
E nesërmja s'e dimë se si do të jetë
E mirë, apo e keqe, nuk dimë se ç'na pret . . .
Gëzim, hare apo . . . vajmedet ?!

Jetë e vështirë me stresa e me halle
Ku hyn për të kërcyer, e mbetesh në "valle"
Një vend pa rregull, me zhurmë e rrëmujë
Ku shpresat po treten si kripa në ujë!

Të rrosh a të mos rrosh, të kesh a të mos keshë?
Ta kalosh jetën gjithnjë duke u ndeshë?
Vitet t'i sosësh me hiri apo pa hiri . . . ?!
Pikëpyetje që s'i dha përgjigje as Shekspiri!

U PAFSHIM PËR TË MIRË!

Lamtumirë, more bir
U pafshim për të mirë!

Kudo që të jetojmë
Zemrat tona të gëzojnë

Në të mira e në halle,
Jeta është punë e madhe

Në gëzime e në mërzi
Kurdo paçim lumturi.

Poezi nga NDUE MICI

REDAKSIA

Kryeredaktore: Suela Ndoja
Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani,
Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku,
Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj,
Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e
Ndue Ziçi.

KRITERET E REDAKSISË DHE NORMAT PËR PUBLIKIM NË GAZETËN E SHOQATËS "DUKAGJINI"

Artikujt e dërguar fillimisht do të vlerësohen nga redaksia. Vlerësimi nga grupi redaktues është i drejtuar për të vlerësuar nëse artikujt e dërguar janë tematikisht sipas kërkesës për gazetën, në përputhje me kodin dhe linjën e redaksisë.

Gjithashtu, kontribuesi / kontribuesit që dërgon / dërgojnë artikullin duhet që të respektojë etikën e të shkruarit.

- "Ndalohet publikimi i artikujve që përmbajnë fjalor joetik dhe janë dukshëm të papërshtatshëm nga pikëpamja etike e një publikimi në gazetë."
- Në rast të refuzimit, autori do të informohet menjëherë me e-mail - brenda 48 orëve - nga redaksia dhe vendimi do të jetë i motivuar në mënyrë korrekte. Kontribuesi nuk duhet kurrësi ta marrë si personale refuzimin e publikimit të gazetës.
- Në raste të tjera, kur një artikull përmban vetëm ndonjë përqindje të ulët (fjalë tek tuk) të përdorimit të fjalëve joetike, atëherë redaksia lind e drejta, që të parashtrijë sugjerime për ndryshimin e tyre duke i zëvendësuar me fjalë, të cilat mund të përcojnë kuptimin, që kontribuesi ka synuar të transmetojë tek lexuesit.

2 - Autorit / autorëve kontribues i/u kërkohet gjithashtu të përshtasë/tin artikullin në standardet e treguara më poshtë.

Artikujt të shkruhen në gjuhën shqipe letrare dhe duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme: nduesanaj@yahoo.it, sundo-prospe@gmail.com ndërmjet datave 15-20 të muajit përkatës. Çdo artikull, që dërgohet pas datës përfundimtare, nuk do të merret në shqyrtim për tu botuar në numrin e caktuar.

FORMATI I ARTIKULLIT

TITULLI-Titulli i artikullit duhet të jetë i shkurtër dhe informativ, por domethënës, që ka lidhje me brendësinë e artikullit. Gjithashtu duhet të shkruhet me SHKRONJA SHTYPI.

PËRMBAJTJA- Teksti i propozuar duhet të shkruhet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, qëllimi i artikullit dhe përmbajtja e përshkruar duhet të jenë të qarta. Sa më shumë që materialet të dërgohen në tekst të thjeshtë, pa formate të çuditshme dhe më pak gabime aq më i mundur do të bëhet redaktimi përfundimtar.

FORMATI I ARTIKULLIT-Duhet që artikulli të dërgohet në Word.

SHKRIMI -Shkrimi të jetë me hapësira 1 dhe pa hapësira të ndërmjetme. Shkrimi duhet të jetë në "Times New Roman".

GJATËSIA E ARTIKULLIT - Jo më shumë sesa 1 faqe format A4 dhe ½. Në raste të veçanta, në varësi të tematikës, mund të pranohen 2 faqe format, se artikujt shumë të gjatë nuk pranohen. Në raste specifike, artikulli do të ndahet në dy pjesë (pra do vijojë numrin vijues të gazetës)

BIBLIOGRAFIA-Duhet të shënohet bibliografia e rregullt nëse i referoheni si citim autorëve të ndryshëm.

KORREKTIMI -Autorëve të artikujve të pranuar për publikim do tu kërkohet, që të korrigjojnë artikujt që dërgojnë, të cilat duhet të kthehen brenda pesë ditëve. Nuk lejohet futja e ndryshimeve thelbësore në artikullin e dërguar më përpara.

TË TJERA - Autori mban përgjegjësi për përmbajtjen e artikullit. Duhet të dërgojë një foto personale dhe adresën e kontaktit elektronik. Materiali i dërguar duhet të shoqërohet me foto të veprimtarisë përkatës, duke përzgjedhur 2-3 foto kryesore. Autori mund të dërgojë 1-2 artikuj për numër gazete, të cilat vlerësohen më pas nga redaksia, që secili prej tyre mund të përbëjë prioritet ose që mund të botohen të dy artikujt.

Redaksia

Mundësuan Botimin:
AVOKATËT DONIKA E AGIM MARTINI

